




VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 11(436)

NENTOR 2024


ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

HISTORIA

SHPALLJA E PAVARËSISË, NJË NGA NGJARJET MË TË RËNDËSISHME NË HISTORINË E POPULLIT SHQIPTAR



FAQE 6-7

80 VJET MË PARË



Muharrem GJOKA

DALI NDREU, STRATEGU QË UDHËHOQI LUFTËN PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS

FAQE 6

112 VJET MË PARË

BETEJA E E DRINIT (KOLESIANIT), PROLOG I PAVARËSISË



BEQIR AJET SHEHU

FAQE 8

80 VJETORI I ÇLIRIMIT – SHQIPËRIA KRENARE PËR KONTRIBUTIN E SAJ REAL NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

LANÇ, NJË NGA FAQET MË TË NDRITURA NË HISTORINË E SHQIPËRISË

LANÇ, lufta e sakrificave të mëdha

Në këtë jubile të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë, ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në këtë fitore të madhe. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjet-amerikane.

VEJON NE FAQEN 2



- Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve. E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë.
- Ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë.

Nga TATJANA PARLLAKU –ÇARKAXHIU
Kryetare e OBVLP **FAQE 2-3**

PARA 8 DEKADAVE SHQIPTARËT U RRESHTUAN NË ANËN E DREJTË TË HISTORISË

Nga Bashkim Hisari **FAQE 10**

PËRURIMI MEMORIAL PËR DËSHMORËT NË PORTËN E PARË TË LABËRISË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI **FAQE 12**

PERSONALITETE SHPENDI DHE SPARTAK TOPOLLAJ, DY PERSONALITETE TË SHQUARA

Nikolla SUDAR **FAQE 3**

PROFILI QAZIM LAÇI, MËSUESI, QË U DOGJ DHE U SHKRI PËR DIJE E DITURI

Shaqir Çerpja **FAQE 11**

REÇENSA DRITA E VETERANËVE ËSHTË DRITA E ATDHETARISË

Nga MEVLUD BUCI **FAQE 9**

PROMOVIMI DR.HASAN DOMI, DY GËZIME NË NJË DITË

Pas Tiranës, vepra enciklopedike “Bimët mjekësore të Korabit” promovohet edhe në Peshkopi, ku nga FPU dr.Hasan Domit iu dha titulli “Ambasador për paqe”

FAQE 16

SUPLEMENTI LETRAT

Në librin e 27-të të autorit, analiza të 40 veprave të 40 autorëve të njohur

ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS

Në analizat e H.Ramës bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësynimin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike

Prof. dr. Eshref Ymeri **FAQE 15**

SELANIK - MUHAREM KAMANI, FITUES I ÇMIMIT TË EKSELENCES NË LETËRSI

FAQE 14

HISTORIA

80 VJETORI I ÇLIRIMIT – SHQIPËRIA KRENARE PËR KONTRIBUTIN E SAJ REAL NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

LANÇ, NJË NGA FAQET MË TË NDRITURA NË HISTORINË E SHQIPËRISË

• *Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve. E çliruan Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë.*



Nga TATJANA PARLLAKU –ÇARKAXHIU
Kryetare e OBVL

Në këtë jubile të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë, ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare që çoi në këtë fitore të madhe. Ne krenohemi sepse me luftën e sakrificat mbinjerëzore, dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane.

Në momentin historik populli shqiptar, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetonte në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës. Në bazë të kësaj lufte e sakricave që bënë partizanët shqiptarë, u sigurua jo vetëm pavarësia e Shqipërisë por edhe e drejta e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje dhe për shqiptarët kudo që jetojnë, e drejta për të qëndruar në trojet e tyre etnike. Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë.

“Në Luftën e Dytë Botërore gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë. Populli shqiptar i Kosovës e ai i shqip-

tarëve të tjerë në trojet e tyre etnike mund të shpënguleshin nga trojet e tyre e të pësonin fatin e atyre shqiptarëve që u dëbuan me forcën e armëve nga serbët në vitet 1870-1880 nga zonat e Nishit, Vranjës, Prokupjes, Leskocit etj dhe të popullit çam. Ky rrezik vinte sepse pushtuesit italianë erdhën me parullën e bashkimit të shqiptarëve nën kurorën e Viktor Emanuelit; krijuan qeverinë kuislinge për ti dhënë pamjen e një shteti të pavarur dhe me shkatërrimin e Jugosllavisë dolën me parullën e Shqipërisë së Madhe. Në këtë mënyrë u përpoqën ta lidhin popullin tonë me bllokun fashist. Të njëjtën rrugë ndoqi edhe Gjermania Naziste pas kapitullimit të Italisë duke mbledhur një Asamble Tradhtare që e shpalli Shqipërinë të Pavarur, pasi gjermanët kishin deklaruar se “ne jemi kalimtarë dhe Shqipëria do të jetë e pavarur!”. Vetëkuptohet, pavarësi me nazistët brenda në Shqipëri! Me këto parulla ata u përpoqën ta joshnin popullin shqiptar, ta mbanin të lidhur me ta dhe me ndihmën e kuislingëve bashkëpunëtorë të tyre ta vinin në interes të tyre kundër Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”, - shkruan ndër të tjera ish – kryetari i OBVL gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe “Nderi i Kombit” në librin e tij “Memoria historike e Kombit”. Referuar këtij libri testament për brezat, gjithkush bindet se po të mos kishte filluar e zhvillohej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar në humnerë bashkë me nazifashistët dhe do të ishin plotësuar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin edhe të shtetit shqiptar, për të cilat punonin edhe qeveritë mbretërore greko-serbe në egzil.

Ishte zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare që përfshiu gjithë Shqipërinë dhe që vetëm brenda vitit 1942 ishin krijuar 22 çeta partizane nga Konispoli në Jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri, jehona e kësaj lufte bëri që ministrat e jashtëm të Anglisë-Iden, i Bashkimit Sovjetik, Mollotov dhe i SHBA-Hell në Dhjetor 1942 të bënin deklaratën “që dëshëronin ta shihnin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të vendoset pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendoset në Shqipëri do të jetë një çështje që do ta vendosë vetë populli shqiptar në fund të luftës”.

Megjithëse në këtë deklaratë qeveria angleze mbante një rezervë kur shprehej se “e sheh çështjen e kufijve shqiptarë pas Luftës si një çështje që duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes”. Kjo deklaratë ishte mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në egzil që përgatisnin plane për copëtimin e Shqipërisë.

Por Lufta Nacionalçlirimtare kishte marrë zhvillime të vrullshme që me krijimin e reparteve sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm me 10 Korrik 1943, ky shtab mori në drejtim dhe çentralizoi veprimet luftarake duke u shtuar goditjet kundër pushtuesve u krijuan zona të lira. Në këto momente aleatët e në radhë të parë anglezët dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm të cilët ndiqnin nga afër Luftën tonë dhe u bindën se e vetmja forcë ushtarake e organizuar në Shqipëri që bënte Luftë të vendosur kundër pushtuesve nazifashistë ishte Ushtria Nacionalçlirimtare. Pas kësaj bindje ata i shtuan misionet e tyre në Shqipëri dhe filluan të na ndihmojnë me armatime e materiale luftarake, megjithëse shumë të kufizuara për shtimin e zgjerimin e Ushtrisë sonë gjatë viteve 1943-1944.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e ushtrive aleate bënë të gjitha përpjekjet për ti bashkuar e futur në luftë forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar e Legalitetit, por nuk patën sukses.

LANÇ, LUFTA E SAKRIFICAVE TË MËDHA

Ushtria Nacionalçlirimtare pasi theu me sukses Operacionin më të Madh të Forcave Naziste e bashkëpunëtorëve të tyre në dimrin e egër të viteve 1943-1944 e kish çliruar hapësira të mëdha të vendit, krijoi kushte për mbajtjen e Kongresit Antifashist në qytetin e çliruar të Përmetit. Nga ky Kongres doli komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore. Pas Kongresit u bënë ndryshime në or-



(Vijon në faqen 3)

HISTORIA



LANÇ, NJË NGA FAQET MË TË NDRITURA NË HISTORINË E SHQIPËRISË

Ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë

(Vijon nga faqja 2)

ganizimin e Ushtrisë. Ajo kaloi nga formacionet e Brigadave në ato të Njësisë të Mëdha të Divizioneve e Koparmatave, të afta për të kryer operacione operative strategjike në të gjitha hapësirat e vendit.

Me thyerjen e operacionit gjerman të Qershorit '44, i fundit i ndërmarrë nga nazistët në vendin tonë, në korrik 1944 forcat e Divizionit të Parë kaluan në mësymje për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, dhe me çlirimin e Matit, të Dibrës e të Lumës, Brigada e Pestë u shkëput nga varësia e Divizionit të Parë dhe së bashku me Brigadën e Tretë morën urdhër të kalojnë në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj.

Detyra kryesore që na ngarkonte Shtabi i Përgjithshëm ishte që në bashkëveprim të ngushtë me forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës të godisnim pa ndërprerje forcat naziste e të shpejtonim çlirimin e Kosovës; të ndihmonim që rinia kosovare të merrte pjesë masive në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me qëllim që Kosova të bëhej pjesë e aleancës antifashiste të popujve që luftonin kundër nazistëve dhe në këtë mënyrë të fitonte të drejtën për vetëvendosje; të ndihmonim për ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara. Për realizimin e këtyre detyrave e drejtimin e veprimeve luftarake u krijua Shtabi i përbashkët Operativ i dy Brigadave dhe Forcave të Kosovës, i përbërë nga Fadil Hoxha - komandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, Shefqet Peçi - komandant i Brigadës së Pestë dhe Hulusi Spahiu - Komandant i Brigadës së Tretë.

Megjithë rezistencën e ashpër të forcave naziste e të mbeturinave të Divizionit ESS Skënderbeg për të mbajtur qytetet Prizren, Gjakovë e Pejë e për të siguruar tërheqjen e shpejtë e të organizuar të reparteve naziste për në Frontin Perëndimor kundër forcave aleate, forcat tona i mundën e i shpartalluan nazistët me luftime shumë të ashpra që u zhvilluan në Gjakovë e sidomos në Junik e Deçan. Në këto luftime Brigada e Tretë ka pas humbjet më të rënda në historinë e saj luftarake; 32 të vrarë e shumë të plagosur. Edhe armiku pati humbje të rënda-shumë të vrarë e të plagosur; shumë me sa më kujtohet rreth 30 rob nga forcat e Divizionit Skënderbeg pasi kishin nxjerrë nga rrethimi komandanët e tyre nëpërmjet një çepengu. Mes tyre kishin qenë Rexhep Deva, Demali Pozhari, një oficer gjerman e të tjerë. Partizanët tanë, të zemëruar nga humbjet e shokëve të tyre

kërkonin me këmbëngulje pushkatimin e robërve. Me shumë vështirësi i bindëm ti lirojmë, pasi ne nuk kishim shkuar në Kosovë për të vrarë vëllezërit tanë po për çlirimin e tyre. Atyre u morëm armët e i liruam duke i porositur të mos shkonin prapë në shërbim të armikut e të vriteshin vëlla me vëlla siç ndodhi në ato luftime.

Duhet ta pohojmë se prej asaj dite, pushkë kosovari nuk qëlloi më kundër nesh. Luftimet për çlirimin e Deçanit, Pejës e gjithë Rrafshit të Dukagjinit përfunduan me 17 nëntor 1944.

“Na vjen keq kur dëgjojmë a shkruhet në ndonjë gazetë se forcat tona kanë vrarë njerëz të pafajshëm në Kosovë. Unë pohoj se kjo nuk ka ndodhur në asnjë rast, përveç kur jemi bdodhur ballë për ballë në luftime. Nuk e di a jeton ndonjë nga të liruarit të jetë dëshmitar i kësaj”, - shkruan në kujtimet e tij gjeneral Parllaku.

LUFTA E BRIGADAVE TONA PËR ÇLIRIMIN E KRAHINAVE TË KOSOVËS DHA NDIHMESË PËR PJESËMARRJEN E DJEMVE TË SAJ NË LUFTË

Referuar librit “Memoria historike e kombit” të gjeneral Parllakut, pjesëmarrja masive në Luftën Nacionalçlirimtare e popullit të Kosovës nën drejtimin e Fadil Hoxhës e shokëve të tij ka qenë vendimtare. Ajo bëri të dështojnë planet e Çubrolloviçit që i kishte servitur komandës së Ushtrisë Jugosllave për sparttimin etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre.

Arkitekti mendimit shovinist serb Vasa Çubrolloviç me elaboratorin e tij të dytë të vitit 1944 jepte direktivën politike se paskësh ardh momenti i përshtatshëm për ti larë hesapet me shqiptarët njëherë e përgjithmonë; se për ti dëbuar nga trojet e tyre..... “asnjëherë ne nuk kemi pasur kushte më të favorshme”. “Luftrat,-vazhdon më tej ai, janë momenti më i përshtatshëm për zgjidhjen e këtyre problemeve”. Ai shpreh bindjen se “aleatët tanë do të na kuptojnë dhe do të plotësojnë dëshirat tona, veçanërisht një shpresë të madhe kemi tek Bashkimi Sovjetik vëlla”. Dhe në fund ideologu shovinist serb jepte direktivën për ushtrinë “Ushtria gjatë operacioneve luftarake duhet të spastrojë në mënyrë të planifikuar e pa mëshirë pakicat kombëtare shqiptare”. Edhe Konferenca e Tre të Mëdhenjve (Çurçill-Stalin-Rustevlt) u jepte të drejtë shteteve fituese në luftë për shpërnguljen e pakicave kombëtare që ishin bashkuar me bllokun fashist. Shembull konkret ishin Rumania që iu shkëput një republikë e tërë-Moldavia nga trojet e veta, pa llogaritur shpërnguljen e më se dhjetë milionë gjermanëve nga Prusia, Krakovia, etj....

Platforma politike dhe ushtarake e Çubrolloviçit, e mbajtur sekret nga Beogradi për çështjen e Kosovës u dogj nga 55 mijë djemtë e saj që morën pjesë në Luftë dhe mijëra dëshmorëve kosovarë që dhanë jetën duke luftuar përkrah forcave antifashiste të botës.

Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë për pjesëmarrjen e djemve të saj në Luftë.

Me largimin e Brigadave tona nga Kosova, në drejtim të Sanxhakut e Bosnjës, forcat serbo-sllave përfshi dhe ato çetnike u përpoqën të vënë në zbatim planin e Çubrolloviçit, por ishte vonë. Forcat shqiptare ishin të armatosura; ata bënë qëndresë të fortë duke luftuar për jetë a vdekje nën komandën e Shaban Palluzhës. Krimet qenë të rënda, por planet e Çubrolloviçit nuk u realizuan. Shqiptarët mbetën përjetë në trojet e tyre etnike. Forcat e dy Divizioneve tona e vazhduan luftën në tokat e Jugosllavisë, duke dhënë ndihmesën e tyre, jo vetëm në çlirimin e krahinave të Malit të Zi, Sanxhakut e Bosnjës por edhe duke penguar, dëmtuar e vonuar forcat naziste që përpiqeshin të tërhiqeshin me shpejtësi e në mënyrë të organizuar për në Frontin e Perëndimit, për të luftuar kundër forcave aleate që kishin zbarkuar në Francë. Luftimet e forcave tona në këto vende janë zhvilluar në kushte tepër të vështira, të një dimri që u kujtonte atë të dimrit '43-'44 në Shqipëri, me mungesë të theksuar në ushqime e mjete të tjera të jetesës. Por ata e kryen me nder detyrën. Dua t'iu kujtoj se në këto luftime kanë rënë afër 600 dëshmorë të dy divizioneve tona. Ky ishte edhe një kontribut i veçantë në Luftën Antifashiste.

Populli ynë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në Luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve; E çliruam Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë Luftë.

Patjetër, ne shprehim falenderimet tona për ndhmën që dhanë Aleatët e Mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA që shkatërruan bishën nazifashiste e u siguruan popujve lirinë.

Lavdi dëshmorëve të Kombit tonë të të gjitha Luftërave çlirimtare.



80 VJET MË PARË

Dali Ndreu, strategu që udhëhoqi luftën për Çlirimin e Tiranës

Muharrem GJOKA
Mjeshtër i Madh & Nënkryetar i OBVLP

Historiografia e sistemit monist për tri dekada (1960-1990) shtrembëroi të vërtetat e një prej epopeve më të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, siç ka qenë beteja për çlirimin e Tiranës. Nën diktatin e nomenklaturës së kohës që synonte zhbërjen e familjeve të mëdha, siç qe ajo e patriotit Elez Isuf Ndreu e Sllovës së Dibrës, u fshi qëllimisht nga historiku i asaj lufte heroike emri i gjeneral – major Dali Ndreut, si drejtues i saj.

Pesë vjet më parë, pikërisht në jubileun e 75-vjetorit të çlirimit të Tiranës, qe prof.dr.Paskal Milo ai që pohoi të vërtetën e pamohueshme të drejtimit të betejës legjendare për çlirimin e kryeqytetit shqiptar prej pushtuesit nazifashist nga general-major Dali Ndreu. Pas shtrembërimeve të qëllimshme nga historiografia komuniste, ky është ndoshta rasti më konkret ku hidhet dritë për një akt kaq madhor. Gjatë një interviste televizive, historiani Milo ndër të tjera tha se: “Urdhëri për realizuar betejën për çlirimin e Tiranës, u dha në fundit e tetorit të vitit 1944 nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për t’u zbatuar nga Korparmata e I-rë me komandant Dali Ndreun, ku në përbërjen e saj ishin disa brigada. Lufta për çlirimin e Tiranës ishte pa dyshim një luftë shumë strategjike, se atëherë kur çlirohet qyteti i një vendi është simbol i çlirimit të gjithë vendit”.

Këtë të vërtetë historike e argumenton më së miri historiani i mirënjohur, Milo, i cili e vlerëson luftën për çlirimin e Tiranës si betejën më të madhe të luftës Nacionalçlirimtare, që kurorëzoi atë fitore, që 12 ditë më pas do t’i vinte vulën çlirimit përfundimtar të Shqipërisë. Dita kur trupat gjermane tërhiqeshin drejt Tiranës dhe u zunë në pritë nga forcat partizane, duke ndezur një betejë gjaku e zjarri për 24 orë rresht, përfundoi me bilancin tragjik të humbjes së jetëve të 2000 ushtarëve gjermanë dhe të afërsisht 300 partizanëve.

Në këtë 80 vjetor të çlirimit të Tiranës nga okupatori nazifashist shqiptarët kujtojnë me nderim e respekt të veçantë ata që ideuan, drejtuan dhe realizuan fitoren e asaj beteje legjendare, heronjtë dhe dëshmorët e saj. Dhe padyshim edhe strategun e kësaj lufte, komandantin legjendar Dali Ndreu.

DALI NDREU, FIGURA NUMËR DY E LUFTËS PARTIZANE

Për vetë postet drejtuese, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare deri zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm, general-major Dali Ndreu, njihet si numri dy i ushtrisë partizane. Kjo edhe për faktin se ka drejtuar me guxim, trimëri e largpamësi disa beteja duke trimfuar ndaj pushtuesit nazifashist të vendit.

Ai ka lindur në Sllovë të Dibrës më 10 mars 1912, në mesin e familjes së madhe të patriotëve Elez Isufi e Sufë Xhelili, të njohur si prijësit legjendarë të luftës 9-vjeçare (1913-1921) të dibranëve kundër shovinistëve serbë.

I biri i Isufit dhe Xhevrijes, i lindur, rritur dhe edukuar në këtë mjedis atdhetarësh do të krijonte një karrierë të shkëlqyer intelektuale e akademike.



Më 1931, pasi kreu studimet në Shkollën Ushtarake të Plotësimit si oficer artilerie u gradua nëntoger. Fillimisht shërbeu në degën e rekrutimit në Përmet, më pas në artilierinë e divizionit “Kosova” deri më 1933.

Pasi kishte rënë në kontakt me lëvizjen komuniste të asaj kohe, u anëtarësua në Grupin e Tiranës të themeluar dhe drejtuar nga arsimtari Hasan Reçi, ku merrnin pjesë shumë oficerë. Ai është në radhën e atyre përparimtarëve të asaj kohe që u dënuan si organizatorë dhe përkatës të Kryengritjes së Fierit më 1935. Pikërisht atëherë u shkarkua si oficer.

Pinjoll i familjes së ndritur të Elez Isufit, i zellshëm për të rritur nivelin arsimor, pas daljes nga burgu, vijoi studimet për Shkenca Ekonomike në Firence.

Në vitet 1940-1941 inkuadrohet në radhët e formacioneve partizane. Ai dha kontribut të veçantë në ngritjen e strukturave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pasi kishte aftësi të spikatura drejtuese dhe organizuese. Siç shkruan dr.Vangjel Kasapi: “Në prill të 1942-shit, para Konferencës historike të Pezës, në Sllovë të Dibrës formohet njësi luftarak, që u rrit në çetë me komandant Dali Ndreun. Kudo në aksione shquhet për trimëri, sidomos për aftësi drejtuese ushtarake. Falë origjinës së familjes, për kontribute të spikatura atdhetare-luftarake, dije profesionale, trimëri, drejtësi, gjakftohtësi dhe komunikim të mirë me njerëzit, prej nga gëzonte ndikim të ndjeshëm në popull, në mbledhjen për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e zgjedh Daliun anëtar

• Në krye të Korparmats së I-rë, gjeneral - major Dali Ndreu, drejtoi mjeshtërisht veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë

dhe zëvendëskomandant të këtij institucioni strategjik ushtarak.

Pas major Spiro Moisiut (komandant), Dali Ndreu vinte figura numër dy ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Luftës dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo u vlerësua si një ngjitje e madhe e dibranit 31-vjeçar. Gjatë përzgjedhjes u vlerësuan aftësitë e shumanshme ushtarake, karakteri i paepur, maturia dhe pjekuria për gjykimin e situatave, në përpunimin dhe marrjen e vendimeve”.

Për meritat e tij, bazuar edhe te kontributi historik i familjes, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare caktohet zëvendëskomandant i Shtabit, pra figura numër dy e luftës partizane. Por njëherësh shquhet si një komandant i zoti me aftësi dhe reputacion.

Brigada e III-të Sulmuese ishte formacioni ushtarak që ai drejtoi në fillimet e Luftës Nacionalçlirimtare.

Pas 24 Majit 1944 drejtoi Divizionin e I-rë Sulmues. Me vendimin nr.11, të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, propozuar me shkresën nr.226, datë 16.8.1944, Dali Ndreu gradohet nga “kolonel” në “gjeneral-major”.

Nga 18 gusht 1944, drejtoi Korparmatsën e I-rë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, i pari dhe më i madhi i formacioneve ushtarake deri atëherë.

Në krye të Korparmatsë I-rë, ai drejtoi mjeshtërisht veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë.

Si udhëheqës i lartë ushtarak, një nga personalitetet e Luftës e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ai zgjodhi e mbajti një qëndrim shumë të arsyeshëm në marrëveshjet me aleatët ushtarakë të Koalicioni Antifashist Botëror. Anëtar i dhe zëvendës i Shtatmadhorisë, komandanti strategjik dhe gjeneral, Dali Ndreu mund të konsiderohet në historiografinë ushtarake të LANÇ-it e të UNÇSh-së, autori i parë i përgjithësimit shkencor dhe i botimit në shtypin ushtarak (gazeta “Luftëtari”, 1945-47, sidomos i tri operacioneve më të mëdha operative-strategjike: thyerja e mësymjeve të përgjithshme naziste të dimrit (1943-44) e të verës (1944) dhe të operacionit mësymës për çlirimin e kryeqytetit – Tiranës, kur autorë të tjerë, gjeneralë e studiues nuk ishin shfaqur në mënyrë kaq sintetizuese në opinion publik, ndonëse më vonë ata i zgjeruan e i thelluan ato operacione madhështore të historisë moderne ushtarake të popullit dhe ushtrisë shqiptare.

Por kuçedra që menjëherë pas çlirimit filloj të hajë bijtë e vetë, do t’i vërsulej pabesisht dhe egërsisht edhe drejtuesit të luftës partizane Dali Ndreu. Strategu që kishte shërbyer në formacionet e Dibrës dhe të Tiranës, ish- anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NAÇL dhe numri dy i saj; ish komandant i Brigadës së Parë, komandant i Divizionit të Parë dhe komandant i Korpusit të Parë deri në çlirimin e vendit dhe pas çlirimit Komandant i Prapavijës në Ushtri, ish- deputeti i parë i Dibrës në legjislaturën e vitit 1945, ndërsa në administratën shtetërore të

(Vijon në faqen 5)



80 VJET MË PARË



Dali Ndreu, strategu që udhëhoqi luftën për Çlirimin e Tiranës

(Vijon nga faqja 4)

pasçlirimit zëvendësministër – njëri nga tre gjeneralët e asaj kohe (përveç E.Hoxhës dhe Spiro Moisu), pikërisht Ai, që në korrik të vitit 1945, ishte dekoruar me medaljen më të lartë të asaj kohe, “Ylli Partizan” të Klasit I-rë, dhjetë vjet më vonë, në vitin 1956 arrestohet në bahçen e tij në Sllovë, për t’u dënuar dhe pushkatuar pas një procesi të montuar politik më 25 dhjetor 1956, sëbashku me Liri Gegën, bashkëshorten e tij.

GENOCIDI I PASHEMBULLT – LIRI GEGËN E PUSHKATUAN SHTATZËNË DHE IA DOGJËN ESHTRAT ME ACID

Kanë kaluar 68 vite që nga dita më e kobshme e jetës së saj, por Lavdie Merlika-Ndreu, vajza e vetme e Dali Ndreut e Liri Gegës, që aktualisht jeton në Laprakë, e ka të ngulitur në memorie ndarjen tragjike me prindërit e saj: çastin e arrestimit, lajmin për vdekjen e tyre dhe pushkatimin e nënës shtatzënë. E rritur me brengën dhe dhimbjen e tyre, kujton se ka qenë vetëm tetë vjeçe atëherë, por i mban mend me detaje rrethanat e tragjedisë dyfishe.

“Sa kishim shkuar te xhaxhai në Sllovë, kur erdhën dhe i arrestuan papritur. Thanë se i kapën në kufi duke u arratisur. Pas tre muajsh mbërriti lajmi se i dënuan me vdekje si armiq të popullit”, kujton ajo.

Ndërsa në dokumentet e Sigurimit rezulton se prindërit e saj, dy nga personazhet e njohura të lidershit komunist, janë pushkatuar në të njëjtën ditë, me akuzën për tradhti ndaj atdheut dhe tentativë arratisjeje për të kaluar kufirin për në Maqedoni, Lavdia thotë se ky është një mashtrim i paskrupullt. “Ata janë arrestuar në oborrin e shtëpisë së xhaxhait, në Sllovë të Peshkopisë. A mund t’i thuash kufi shtetëror portës së gjyshit ku kishim shkuar për të qëndruar disa ditë?! Marrëzi, marrëzi pa fund... Atë skenë e kam parë nga afër. Atëherë isha tetë vjeçe. Arsyeja që kishim shkuar në vendlindjen e prindërve në Sllovë lidhej me shëndetin e vëllait, Sokolit. Ai ishte dy vjeç dhe vuante nga një sëmundje kronike. Ishte kurrar për të disatën herë në spitalin e Tiranës. Mjekët më në fund kishin rekomanduar të frekuentonte klimë malore. Pas konsultës me ta, prindërit vendosën të shkonim në Sllovë. Aty kemi mbërritur një natë para se t’i arrestonin”, kujton Lavdia me sytë e përlotur. Sot ajo është bërë gjyshe dhe kujton gjithë genocidin që kaloi familja e saj dhe gjithë fisi emëndritur Ndreu i Sllovës.

Me prindërit është ndarë kur ishte tetë vjeçe. Asokohe jetonin në katin e dytë të një shtëpie private te Rruga e Kavajës. Dali Ndreu e Liri Gega kishin ardhur aty fill pas luftës. “Babai, me sa mbaj mend, ishte drejtor i ndërmarrjes së ndërimit, po shpesh i flisnin gjeneral. Mamaja punonte

mësuese në shkollën pedagogjike te Rruga e Elbasanit. Unë vazhdoja shkollën te ‘Hasan Vogli’. Si fëmijë, kuptohet nuk kisha si t’i dija peripecitë që kishin kaluar prindërit deri atëherë. Ajo që ndieja ishte rrallimi i vizitave të miqve dhe shokëve të tyre, të cilët dikur hynin e dilnin shpesh”,-kujton Lavdia. Por gjithsesi, nga memoria e saj nuk shqitet momenti i arrestimit të prindërve. “Teksa rrija e shtangur para gruas së xhaxhait, dëgjova zërin e mamasë që i thoshte: Amanet djalin, Sokolin! Sakaq, u hodh babai qortueshëm: Amanet Lavdijen, se ajo do t’i mbajë mend të gjitha! Kaq ishte gjithçka. Ku ta dija se ai do të ishte komunisti i fundit me ta. Tek u ndamë, i ndoqa me sy derisa i futën forcërisht në makinë. Deri në fund mamaja nuk i shkëputi sytë nga unë...”.

Rrëfim vërtetë tronditës i vajsës së një prej gjeneralëve më të shquar të LANÇ-it. Dali Ndreu dhe bashkëshortja e tij Liri Gega u eliminuan nga diktatori E.Hoxha me skenarin ogurzi të tradhtisë ndaj atdheut. Diktatori shihte ëndërra me skenarë të sajuar për rrëzimin e tij nga fronti, ndaj dhe nuk nguroi të shpallë armiq e të eliminojë një nga një ish – gjeneralët që organizuan dhe udhëhoqën Luftën e

lavdishme nacionalçlirimtare. Vetëm një mendje e çmendur mund të shpallte “agjent të Beogradit” dhe me këtë akuzë absurde të ekzekutonte një gjeneral të shquar si Dali Ndreu, pinjoll i një fisi të madh dhe të njohur për tradita patriotike. Dhe për më tej të arrinte deri na aktin makabër të ekzekutimit të nënës shtatzënë (me fëmijë në bark) Liri Gega dhe të djegies së eshtrave të saj me acid...

DALI Ndreu, nga “ARMIK I DIKTATURËS” SOT “NDERI I KOMBIT”

Shtatëmbëdhjetë vjet më parë, më 15 gusht 2007, në Qendrën Kulturorë të Ushtrisë Tiranë (ish-SHQUP), u organizua ceremonia e dekorimit të Gjeneral Dali Isuf Ndreu, me Urdhërin e lartë “Nderi i Kombit” (pas vdekjes), akorduar nga ish-Presidenti i Republikës, SHT Z. Alfred Moisiu, me dekret Nr 5403, datë 17.07.2007. Ceremonia u organizua nga Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it. Në këtë ceremoni ku morën pjesë personalitete të larta politike të asaj kohe, deputetë e oficerë madhorë, miq dhe të afërm të familjes Ndreu, mbi jetën dhe aktivitetin e gjeneral Dali Ndreut, foli Heroi i Popullit, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku. Mbi të gjitha, Parllaku evidentoi rolin determinant të gjeneral-major Dali Ndreut në luftën për çlirimin e Tiranës.

“Drejtimi i Operacionit iu ngarkua komandës së Korparmatës së Parë me komandant gjeneral Dali Ndreun, e cila krijoi një grup operativ për drejtimin e luftimeve në kryeqytet. Për zhvillimin me sukses të operacionit, Komanda e Përgjithshme i dha në vartësi Korparmatës së Parë, përveç tri brigadave: I, IV dhe III, edhe brigadat e XV dhe XXIII.”, -tha ndër të tjera gjeneral Parllaku në atë ceremoni mbresëlënëse, ku me propozimin e tij, Dali Ndreu, i dënuar dhe ekzekutuar tragjikisht nga diktatura komuniste, tashmë do të shpallej “Nderi i kombit”.

Dhe duke rrëfyer të vërtetat e LANÇ-it Parllaku vijoi: “Kush e ka drejtuar këtë luftë?! Mos vallë “jashtëtokësorët”, pasi nuk ka asnjë emër komandanti nga Korparmata, grupi i drejtimit direkt të luftës në qytet dhe të asnjë komandanti të 11 brigadave!!!! Për mua nuk përbën ndonjë çudi, por ndonjë i ri ose persona që e dinë se njësitë e repartit në luftë komandohen, duan të dinë se kush ka qenë në krye të këtyre reparteve. Prandaj nuk përmenden emrat e gjeneral Dali Ndreut – komandant i Korparmatës I-rë, që drejtoi operacionin për çlirimin e Tiranës, Mehmet Shehut –komandant i divizionit dhe drejtues i shtabit të këtij operacioni, si dhe emrat e drejtuesve të tri brigadave që vepruan direkt dhe drejtuan me mençuri, largpamësi, guxim e heroizëm luftimet e kryeqytetit, si: Muhamet Prodani, Arif Hasko, Nexhip Vinçani, Pëllumb Dishnica, Qazim Kondi e Bajram Sinojmeri. Të tillë kanë qenë edhe drejtuesit e 8 brigadave të tjera, po edhe emrat e tyre nuk përmenden.”

Do të duhej kjo dëshmi e legjendarit në kufirin e dy kohëve, Rr.Parllaku (i cili fatmirësisht jetoi një shekull dhe la të shkruar të vërtetat e pamohueshme të LANÇ-it), për të hedhur dritë mbi të vërtetën e organizimit e të drejtimit të betejës për çlirimin e Tiranës dhe për vlerësimin e komandantit të kësaj beteje Dali Ndreu, duke i dhënë atij dekoratën e lartë “Nderi i Kombit”. Dali Ndreu ishte një yll që shkëlqeu në vargun e personaliteteve ushtarake shqiptare, por që, për fat të keq, u fik shpejt, atëherë kur mund të ndriçonte më tepër.



HISTORIA

Akti i Shpalljes së Pavarësisë, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar

28 Nëntor 1912 - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë

Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për të gjithë popullin shqiptar dhe për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftën për çlirimin kombëtar, me pushkë dhe me penë

Më 28 Nëntor 1912, Kuvendi Kombëtar i Vlorës shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ai ishte fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës.

28 Nëntori i vitit 1912 shënon një kthesë historike për popullin shqiptar, sepse nga njëra anë mori fund sundimi gati pesëshekullor i Perandorisë Osmane, nga ana tjetër u krijuan kushtet e reja politike për të dalë nga prapambetja e madhe dhe për zhvillimin e tij më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor. Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e madhe e shqiptarëve edhe kundër politikës antishqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për të gjithë popullin shqiptar dhe për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftën për çlirimin kombëtar, me pushkë dhe me penë.

SHPALLJA E PAVARËSISË: NGJARJET SIPAS KRONOLOGJISË

Në vitin 1912, situata në Ballkan ishte mjaft e trazuar, për shkak të ngjarjeve që po ndodhnin njëra pas tjetrës. Ndërkohë, Perandoria Turke po përjetonte një krizë të gjithanshme. Më 11 Janar të atij viti, patrioti Hasan Prishtina paralajmëroi në Parlamentin turk për një kryengritje të re në Shqipëri, po të mos plotësoheshin kërkesat shqiptare.

Më 18 Janar xhonturqit shpërndanë Parlamentin dhe shpallën zgjedhjet e reja. Në 13 Mars, u nënshkrua marrëveshja serbo-bullgare, mbi bazën e së cilës u formua "Aleanca Ballkanike". Në muajin prill shpërtheu kryengritja kundër xhonturqve në Malësinë e Gjakovës. Në 21 deri në 25 maj, zhvilloi punimet Kuvendi i Junikut, i cili hartoi programin e autonomisë të kryengritjes së përgjithshme. Ndërkohë, në maj, kryengritja kundër xhonturqve u shtri në zonën e Pejës, të Lumës, të Mirditës e të Zadrimës.

Në fillim të muajit qershor, forcat kryengritëse të



udhëhequra nga Bajram Curri shpartalluan forcat turke në Qafën e Prushit. Në datat 28 dhe 29 qershor, kryengritësit e udhëhequr nga Isa Boletini, shpartalluan batalionet turke tek Ura e Senicës. Gjithashtu, brenda këtij muaji, kryengritësit shqiptarë, zhvilluan luftime me forcat turke në zonën e Prishtinës, të Pazarit të Ri dhe të Vushtrrisë, ndërkohë që, në datën 4 korrik, morën Krujën dhe në 17 Korrik, hynë në Gjakovë.

Në të njëjtën datë, kryengritja shqiptare, e detyroi qeverinë xhonturke të Said Pashës të jepte dorëheqjen. Në datën 5 gusht, sulltani shpërndau Parlamentin dhe dekretoi zgjedhjet e reja. Ndërkohë, pas këtyre zhvillimeve të vrullshme, që u pasuan edhe me ngjarje të tjera, në 8 tetor, Mali i Zi i shpalli luftë Turqisë dhe në 17 dhe 18 tetor, të njëjtën gjë bëjnë edhe Serbia dhe Turqia, gjë që shënoi edhe fillimin e luftës ballkanike. Në tërësi, kjo luftë drejtohej kundër Turqisë, por ë një moment të caktuar të zhvillimit të saj, fqinjët kthyen sytë nga Shqipëria, duke synuar copëtimin e saj.

Fitoret e shteteve ballkanike ndaj Turqisë, i detyruan Fuqitë e Mëdha të rishikonin vendimin e tyre për të mos lejuar ndryshimet territoriale në Ballkan, në

favor të interesave të aleatëve ballkanikë. Në rrethana të tilla, patriotët shqiptarë që ndodheshin jashtë atdheut vendosën të ndërmerrnin një veprim të ri politik, me synimin për të parandaluar dhe për të mos lejuar copëtimin e Shqipërisë. Gjithashtu, do të synohej ruajtja e tërësisë tokësore, duke u mbledhur një kuvend kombëtar ku do të vendosej për fatin e saj.

Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi u nisën nga Stambolli dhe arritën në Bukuresht, ku, më 5 nëntor 1912, organizuan mbledhjen e kolonisë shqiptare. Këtu u vendos të krijohej një Komitet Drejtues, të krijohej një komision që do të shkonte në kancelaritë evropiane, për të mbrojtuar përpara qeverive të Fuqive të Mëdha, të drejtat e kombit shqiptar.

Ndërkohë, komiteti i Bukureshtit do të koordinonte veprimtaritë e komiteteve brenda e jashtë Shqipërisë. Por në këtë mbledhje, nuk u përcaktua me saktësi, në se do të ishte autonomia, apo pavarësia synimi i afërt. Pjesë e përpjekjeve diplomatike ishin edhe takimet që, Ismail Qemali zhvilloi në Vjenë me kontin Berthold dhe ambasadorin Italian. Ndërkohë, Ismail Qemali u njoftua për lëvizjen që kishte filluar në Shqipëri për mbledhjen e një kuvendi kombëtar. Ndërkohë, ushtria osmane në Ballkan ishte shpartalluar në të gjitha frontet dhe trupat serbe, malazeze e greke kishin hyrë thellë në tokën shqiptare.


Në këto kushte, grupi i atdhetarëve I kryesuar nga Ismail Qemali, vlerësoi se, e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare ishte ajo e shpalljes së pavarësisë.

Në 19 nëntor, Ismail Qemali do të deklaronte nga Trieste, gjatë rrugës për në Shqipëri, se, menjëherë pas mbërritjes së tij në Shqipëri do të shpallej pavarësia e Shqipërisë dhe do të zgjidhej qeveria e përkohshme. Ideja e pavarësisë së Shqipërisë dhe lajmi i mbledhjes së kuvendit kombëtar u pritën me entuziazëm në Shqipëri, ku ndërkohë lëvizja atdhetare po përgatiste rrethanat. Ismail Qemali, i shoqëruar nga patriotët të tjerë, arriti në Durrës, në datën 21 nëntor, për të ngritur flamurin në këtë qytet. Por, për shkak të rrethanave të kohës dhe kundërshtimit të qarqeve të caktuara shoviniste, kjo përpjekje dështoi.

Së bashku me delegatët e Durrësit, Shijakut, Tiranës e Krujës, Ismail Qemali



87 VJETORI I RËNIES



(Vijon nga faqja 5)

me shokët e tij u nisën për në Vlorë. Në Fier u bashkuan me një pjesë të delegatëve nga Kosova dhe, në 25 nëntor, arritën në Vlorë. Menjëherë nisën përpjekjet për organizimin e forcave të armatosura, duke ngritur një komision të posaçëm dhe bashkëpunimin me pleqësitë e fshatrave, për mobilizimin e njerëzve të aftë për të luftuar. Kjo, u diktua edhe nga keqësimi i rrethanave, për shkak të përparimit të ushtrisë serbe në territorin shqiptar. Ndërkohë, flamuri kombëtar ishte ngritur në Elbasan, Durrës, Tiranë, Kavajë, Peqin e Lushnjë.

Në rrethana të tilla, delegatët që ndodheshin në Vlorë vlerësuan se, duheshin përsheptuar procedurat për ngritjen e Flamurit dhe shpalljen e pavarësisë kombëtare. Në mbrëmjen e datës 27 nëntor u vendos që, të nesërmen të mbledhjet Kuvendi Kombëtar, megjithëse, nuk kishin arritur ende mjaft delegatë nga trevat e ndryshme të Shqipërisë.

Sipas historianëve dhe dokumenteve të kohës, Kuvendi Kombëtar i çeli punimet në orën 15.30 të ditës së nesërme. Në të morën pjesë 37 delegatëve, të cilët u shtuan më pas deri në 63 vetë dhe përfaqësonin të gjitha viset shqiptare duke qenë në një masë të madhe, udhëheqës dhe aktivistë të lëvizjes atdhetare. Mes tyre ndodheshin Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqi, Murat Toptani, Lef Nosi, Mithat Frashëri, Patër Anton Harapi, Sali Gjuka, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Vehbi Agolli, Dhimitër Zografi, Nikollë Kaçorri, Jani Minga, Abdi Toptani, Pandeli Cale, Dudë Karbunara, Mehmet Dërralla, Hasan Hysen Budakova, Ajdin Draga, Sherif Dibra, Dhimitër Mborja, Shefqet Daiu, Rexhep Ademi, Dhimitër Berati, Kristo Meksi, Xhelal Koprëncka, Iljaz Vrioni, Hajredin Cakrani, Shefqet Vërlaci etj. Kuvendi zgjodhi si kryetar Ismail Qemalin.

Në fjalën e tij, patrioti i madh nënvizoi se në kushtet e krijuara, e vetmja rrugë për shpëtimin e atdheut ishte ndarja e Shqipërisë nga Turqia dhe shpallja e pavarësisë. Ky propozim u miratua unanimisht nga delegatët që nënshkruan edhe dokumentin e pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë dokument theksohej mes të tjerash se "...Shqipëria me sot, të bëhet më vehte, e lirë, e mosvarme".

Në këtë kuvend u krijua edhe Qeveria e Përkoshme, si dhe u emërua Pleqësia, ose Senati. Këto propozime u miratuan njëzëri nga Kuvendi Kombëtar. Menjëherë pas kësaj, u shpall Qeveria e Përkoshme, si dhe u zgjodhën anëtarët e senatit, i përbërë nga 18 anëtarë, me kryetar patriotin Vehbi Dibra. Në përbërjen e qeverisë dhe të senatit u zgjodhën njerëz me kontribut të spikatur atdhetar dhe përfaqësues të të gjitha trevave e të tri besimeve fetare. Procedurat e mëtejshme vazhduan me nënshkrimin e aktit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare nga të gjithë delegatët. Në orën 17.30 të

28 Nëntor 1912 - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë

Megjithëse, Konferenca e Ambasadorëve të Gjashtë Fuqive të Mëdha në Londër, në vitin 1913, nuk arriti të bashkonte në një shtet të vetëm të gjithë territoret shqiptare, 28 nëntori vlerësohet si ngjarja me e madhe, unike në historinë e Shqipërisë

datës 28 nëntor, Ismail Qemali, doli në ballkonin e godinës ku u mbajt Kuvendi dhe njoftoi Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, duke ngritur Flamurin e qëndisur nga atdhetarja Marigo Posio.

Me aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Kryetari i Qeverisë së Përkoshme, Ismail Qemali, njoftoi gjashtë Fuqitë e Mëdha, Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë. Po ashtu, u njoftuan edhe shtetet ballkanike, Rumania, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, Greqia e Turqia, duke u kërkuar njohjen e pavarësisë, si rrjedhojë e natyrshme e vullnetit të popullit shqiptar.

Ndërkohë, në përbërjen e Qeverisë së Përkoshme, mes të tjerash përfshiheshin: Ismail Qemali, Kryeministër dhe Ministër i Jashtëm; Petro Poga, Ministër i Drejtësisë; Myfid Libohova, Ministër i Brendshëm; Abdi Toptani, Ministër i Financave; Luigj Gurakuqi, Ministër i Arsimit; Mithat Frashëri, Ministër i Punëve Botore; Lef Nosi, Ministër i Postëtelegrafës.

Akti i shpalljes së pavarësisë u përshëndet nga populli i mbledhur në shesh, ndërkohë që, patriotët Jani Minga e Murat Toptani, mbanin fjalime gjatë manifestimeve në rrugët e qytetit. Ndërkohë, Isa Boletini, mbërriti në Vlorë, një ditë pas aktit të shpalljes së pavarësisë, në krye të 400 luftëtarë, të gatshëm të mbrojnë qeverinë dhe tërësinë territoriale. Trupat e komanduara nga Isa Boletini, u vendosën në dy pozicione në lagjet Muradie dhe Topana. Madje, në përkujtim të kësaj, bashkia e qytetit të Vlorës, i vendosi emrin e Boletinit, një rrugë të lagjes "Topana", e cila vazhdon të njihet me këtë emër edhe sot.

Pas largimit të tij, nga Vlora, Isa Boletini la në shërbim të qeverisë së Ismail Qemalit, 25 burra nga Kosova, të cilët qëndruan në Vlorë deri në vitin 1925. Ata i shërbyen Qeverisë së Përkoshme dhe më pas, vendosjes së rendit, ndërkohë që ishin akomoduar në një godinë dy katëshe, në afërsi të sarajeve të familjes Vlora, e cila nga vlonjatët e vjetër, është njohur ndryshe si "shtëpia e kosovarëve".

Aktiviteti i Qeverisë së Përkoshme, mbrohej garantohet nga forcat e sigurisë, të cilat ishin ndarë në toga, me komandantët përkatës, me 32 luftëtarë secila. Mes tyre spikasin togat e komanduara nga Ahmet Lepenica, Ahmet Muka, Tol Arapi, Azis Çami, Thanas Beni, Cen Sharra. Ndërkohë, shef protokollit ishte Hasan Sharra. Dokumenti original i Aktit të Shpalljes së Pavarësisë, u ruajt në mjediset e Muzeut të Pavarësisë,

që si edhe sot, funksiononte në të njëjtën godinë. Më pas, në vitin 1937, ajo u zhduk. Një kopje origjinale të saj, e ruajti Lef Nosi, ish Ministër i Postë Telegrafës, i cili sipas, historianit Bardhosh Gaçe, e ruajti deri vonë.

Në fakt, godina ku u zhvillua Kuvendi Kombëtar, ishte një nga dy sarajet e familjes së njohur të Vlorajve, pinjoll i së cilës ishte edhe patrioti Ismail Qemali. Këto saraje, të përbëra nga dy godina madhështore, pronë e Xhemil Beut, kushëri i parë i Ismail Qemalit, ndodheshin në vendin ku sot është Sheshi i Flamurit, ose më saktë në pjesën ku ngrihet Monumenti i Pavarësisë dhe ku shtrihet Lulishtja e madhe. Kuvendi u mbledh në pjesën e sarajeve, që emërtohej ndryshe "selamllëku", që ishte edhe godina më e madhe që sot përkon me pozicionin karshi hotel Sazanit.

Sipas historianit Bardhosh Gaçe, ngritja e flamurit u realizua në dy kohë; fillimisht në ballkonin e katit të dytë, që ishte njëkohësisht edhe hyrja për në godinë dhe, më pas, në një nga dritaret e të njëjtit kat. Madje, kjo dritare përkon me vendin ku sot ndodhet Shtiza e Flamurit. Nga ky akt, nuk pati fotografi, sepse mungonin fotografët e kohës. Por, fotoja që përjetëson ngritjen e flamurit nga Ismail Qemali, në ballkon, u realizua një vit më pas, në 28 nëntor të vitit 1913, në godinën ku u vendos Qeveria e Përkoshme, në skelë, aty ku ndodhet sot, Muzeu i Pavarësisë. Kjo foto, u realizua nga Marubi i famshëm i Shkodrës.

Sarajet e Vlorajve, kanë ekzistuar deri në vitin 1925, kur ato u prishën, për t'ja lënë vendin ndërtimit të Lulishtes së Madhe, në Sheshin e Flamurit. Pinjollët e familjes së famshme, u zhvendosën në godina të tjera, mes të cilëve, Syrja Beu (babai i Eqerem Bej Vlorës), pak metra më tutje, në godinën që sot emërtohet "shtëpia e Beut" dhe Siri Beu, në Ujin e Ftohtë, në një vilë që përkon me kodrën ku sot ndodhet njera prej vilave të shkatërruara në vitin 1997, të ish udhëheqjes komuniste, në Ujin e Ftohtë. Me nismën e Dom Markut, u konceptua skema e Shtizës së Flamurit, e cila u ndërtua pak vite më vonë. Kjo shtizë, është ndërtuar e rindërtuar disa herë në pozicione të ndryshme dhe, aktualisht, vendndodhja e saj, përkon me dritaren ku u ngrit flamuri nga Ismail Qemali. Madje edhe lartësia e saj, sipas Gaçes, është e njëjtë me atë të katit të dytë të godinës së Vlorajve. Shtiza e Flamurit, u realizua përfundimisht, nga Ali Asllani, dy herë kryetar bashkie, i Vlorës, në vitin 1918 dhe 1938. /ATSH/

Telegrafisti që njoftoi aktin e Pavarësisë

Pas vendimit dhe nënshkrimin të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, Ismail Qemali, Kryeministër, dorëzoi tekstin e njoftimit për Fuqitë e Mëdha dhe shtetet ballkanike. Teksti u përcoll tek zyrat e Telegrafës, që ndodheshin pak metra më tej, në katin e parë të godinës së njohur të Sharrajve, e cila ka ekzistuar deri në mesin e viteve 1980-të. Mes punonjësve të kësaj zyre, ishte edhe Faik Kreshpa, një djalosh i ri, të cilit i ra shansi imadh të transmetonte tekstin e njoftimit të Shpalljes së Pavarësisë. Por, ky emër mbeti i panjohur për komunitetin. Propoganda komuniste e la atë në harresë,

megjithëse Faik Kreshpa, ishte një qytetar i nderuar i Vlorës. Ai ka jetuar në Vlorë, deri në fillim të viteve 1960-të, kur ndërroi jetë, duke lënë pas, trashëgimtarë. Por, pak-kush prej bashkëqytetarëve të tij, e dinte se, pikërisht ai ishte telegrafisti që njoftoi botën mbarë, për aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Megjithëse, Konferenca e Ambasadorëve të Gjashtë Fuqive të Mëdha në Londër, në vitin 1913, nuk arriti të bashkonte në një shtet të vetëm të gjithë territoret shqiptare, 28 nëntori vlerësohet si ngjarja me e madhe, unike në historinë e Shqipërisë.

112 VJET MË PARË - 14-19 NËNTOR 1912

BETEJA E E DRINIT (KOLESIANIT), PROLOG I PAVARËSISË

BEQIR AJET SHEHU*

Beteja e Lumës meriton vëmendjen e duhur nga historiografia jonë kombëtare, pasi ajo pengoi drejtpërdrejt forcat e Armatës së Tretë serbe, duke i gjakosur, rraskapitur e vonuar në realizimin e qëllimit serb, për të dalë në Adriatik e për të bërë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë para Shpalljes së Pavarësisë sonë Kombëtare

Me pushtimin e Prizrenit, komandanti i divizionit të tretë serb, gjenerali Jankoviç, nisi rigrupimin e forcave për operacionin drejt bregdetit shqiptar. U krijua divizioni "Shumadia", me 7 regjimente, me këmbësorë, kalorësi, artileri, reparte vullnetare dhe reparte të komitës serbe. Këto forca do të pushtonin Lumën dhe, pasi të bashkoheshin me forcat e divizionit "Morava", që do të vinte nga Dibra, do të vazhdonin operacionin drejt luginës së Fanit, të Matit e të Shkumbinit për të dalë në Adriatik.

Fronti i qëndresës shqiptare, i përqendruar në Has, Lumë, Gorë e Opojë, po punonte në të gjitha drejtimet për t'i thënë ndal marshimit të mëtejshëm të forcave serbe. Pas tërheqjes nga Gjakova, Rahoveci e Prizreni, forcat shqiptare u ngjeshën në zonën e Opojës dhe të Lumës. Me forcat e Lumës u bashkuan edhe Isa Boletini e Bajram Curri, të cilët u vendosën në zonën e Hasit për të mbrojtur Qafën e Prushit. Bajraqtet e Lumës, me prijësit popullor: Ramadan Zaskoci, Islam Spahia, Ramadan Çajku, Osman Lita, Qazim Lika, Sheh Sali Çaja, së bashku me të gjithë bajraktarët, formuan Këshillin e Luftës, me qendër në Kolesjan, ku do të vihej postblloku i pakalueshëm për forcat serbe. Mbi 25000 luftëtarë të forcave shqiptare ishin përqendruar në pjerrësitë e maleve të Koritnikut e të Pashtrikut, si dhe në malet e Sharrit e të Korabit, për të siguruar një vijë mbrojtjeje sa më rezistente dhe me objektiv edhe për të kundërsulmuar. Në kujtimet e Tafil Boletinit jepet një pasqyrë e qartë e përgatitjeve, që po bënin krerët e Lumës për të përballuar agresionin serb, i cili kishte arritur në portat veriore të krahinës. Në besëlidhjen mbarëkrahinore në Bicaj dhe në tubimet e fshatrave Kolesjan, Ujmisht e Vasije, mori pjesë edhe Isa Boletini, i cili këshilloi për lënien mën-



janë të hasmërive, për shmangien e mosmarrëveshjeve, për lidhje mes katundeve e krahinave, se vetëm duke qenë të bashkuar mund të përballohej kjo "murtajë e zezë", që po rrezikonte vendin dhe jetën e fëmijëve tonë.

Me 10 nëntor Luma sulmohet frontalisht nga 16 mijë forca serbe, të pajisura me armët më moderne të kohës, me artileri e kalorësi, kryesisht armatim francez. Beteja e parë e përgjakshme u zhvillua në Qafën e Zhurit dhe në grykën e Morinit, ku armiku pati humbje serioze, por arriti të futej në Rrafshën e

Lumës dhe 12 batalione arritën deri në Bicaj.

Me 14 nëntor, kur forcat serbe do të marshonin drejt Qafës së Kolesjanit, për të dalë në Kala të Dodës, komanda serbe u informua se "Rreth 2000 shqiptarë të armatosur ishin pozicionuar në formë patkoi, duke harkuar mbi pozicionet serbe, poshtë Qafës së Kolesjanit, nga lindja e perëndimi".

Ky informacion për forcat armike ishte vetëm një pjesë e së vërtetës, pasi Këshilli i Luftës, i vendosur në Kolesjan kishte përgatitur një vijë mbrojtjeje të pakalueshme për forcat serbe.

Duke u nisur nga përvoja e luftës me Xhavit Pashën në vitin 1909, ku pozicioni më i përshtatshëm strategjik për mbrojtje ishte Qafa e Kolesianit dhe sulmin e Dervish Pashës në tri drejtime për të hyrë në Lumë, në vitin 1910, krerët e Lumës, morën masa për të siguruar Grykën e Vanave, Shkallën e Keqe e Lakun e Darzës nga lindja, si dhe tërë gjatësinë e Ujit të Lapave, nga jugu. Forcat kryesore që do të hynin në betejë, rreth 3000 luftëtarë, u vendosën në dy skalione:

-Skalioni i parë u vendos në faqen perëndimore të Gjalicës, në Theth, në Lakun e Darzës, në Qafën e Kolesjanit, në Kodrat e Gabricës e në Drin të Zi. Në një thellësi 2-3 km

u pozicionuan luftëtarët e skalionit të dytë, në gjatësinë që shkonte nga Mali i Limthit-Qafa e Reskut-Qafa e Drajës-e në Drin të Zi. Qendra e prapavijës së skalionit të parë, u vendos te Gurra e Kolesjanit. Shtabi kryesor i luftës u vendos në Qafë të Kolesjanit, në majën e quajtur Tabe, nga ku shikoheshin pothuaj të gjitha vendet, ku ishin vendosur në mbrojtje luftëtarët lumjanë dhe e gjithë Rrafsha e Lumës, që do të kthehej në arenë luftimesh. Forcat kryesore mbrojtëse e goditëse në Qafën e Kolesianit përbëheshin nga malësorët e shtatë bajraqeve të Lumës. Me 13 nëntor, arriti në Kolesjan edhe legjendari Elez Isufi me malësorët e Reçit e Dardhës, i cili iu bashkua Këshillit Drejtues të luftës. Me Elez Isufin erdhi edhe oficeri i artilerisë, Cen Daci, i cili me dy topat që solli, që ia patën mbajtur në Kala të Dodës ushtrisë turke, do të bëhej tmerri i artilerisë serbe.

Duke menduar për një sulm të mundshëm në front të gjerë të forcave serbe, krerët e Lumës, në marrëveshje me krerët e Hasit e të Opojës, vendosën për një vijë mbrojtjeje, që do të fillonte nga pjerrësitë perëndimore të Malit të Sharrit në Grykën e Llapushnikut, e cila do të mbrohej nga opojas, goranë e topojanas, nën drejtimin e Qazim Likës dhe nga Drini i Bardhë e deri në Qafën e Prushit, që do të mbrohej nga hasianë me kryeprijës Rexh Ali Bajraktarin.

Komanda e përgjithshme e grupimit, tanimë me lumjanë e dibranë, me Ramadan Zaskocin, Elez Isufin, Islam Spahinë e Ramadan Çajkun, u vendos në Kolesjan.

Mëngjesi i 15 nëntorit i gjeti luftëtarët lumjanë e dibranë në prita e llogore. Çastet e ankthit, që përjetoheshin në ato orë mëngjesi, para fillimit të betejës, i përshkruajnë realisht, vargjet e këngës, që populli ka thurur për këtë betejë:

Kolesjani shtatëdhjet shtëpi,
mbanin hutat bitim në sy.

Të dy palët synonin befasinë. Armët ishin të mbushura. Llogoret s'i mbanin më luftëtarët. Pritej vetëm sinjali i sulmit. Ramadan Zaskoci, komandant dhe luftëtar në dhjetëra beteja, nga Tabja, ku ishte vendosur shtabi i luftës, hodhi sinjalin e goditjes mbi forcat serbe, që po ngjiteshin drejt Qafës së Kolesjanit. Ibrahim Zeqir Gjorgji, bajraktari i Radomirës, i pari u hodh në sulm dhe mori nderin e pavdekshmërisë, si dëshmor i parë i kësaj beteje leg-

(Vijon në faqen 9)



RECENSA

FIGURAE FILOZOFIT DHE PRIJËSIT POPULLOR DINE HOXHA NË NJË KËNGË TË NAIM BERISHËS

Drita e veteranëve është drita e atdhetarisë


MEVLUD BUCI

Autorët e monografisë "DINE HOXHA- NJË FILOZOF POPULLOR NË OBORRIN MBRETËROR", Halil Rama e Shaqir Skarra, na kanë dhënë në këtë libër një testament fisnikërie për Dibrën, po aq, edhe Naim Osman Berisha e ka lartësuar në këngën e tij "Dine Hoxha me dibranë".

Kjo këngë epike të emocionon, të ngjall dhe të ndez krenarinë, sepse aty shpërfaqet me mjeshtëri madhështia e kësaj figure, si filozof e prijës popullor, pasqyrohet në të, thirrja për bashkim, si himn lirie.

Katër Grykët, Muhurri e Luzni,
E vranë serbin e hodhën në Dri...

Vargje domethënëse që flasin për përmasat e asaj epoke luftarake, të asaj lufte që vjen përmes këtyre vargjeve sintetikë, që pasqyrojnë një kohë të madhe të bashkimit e të ndërgjegjësimit krahinor e kombëtar.



Ndal mor serb, o bir i shkinës
Jemi Muhurri zemra e Dibrës,
O mor serb, mor i mallkue,

Drita e veteranëve është drita e atdhetarisë, dritë që e shohim te Naim Berisha, poet, fabulist, shkrimtar e këngëtar. Ai na ka dhuruar këngën - monument për Dine Hoxhën

Ktu i thonë vend i bekue..

Dine Hoxha ka ngrit zanin
Bini djem se shkoi vatani,
Ma faroi asqerin e ngratë
Dine Hoxha me muhurrakë

Na e faroi asqerin të tanë
Dine Hoxha me dibranë...
Hajde, hajde, or Dine Aga
Lum ky Muhurri që të paska,

Teksti dhe melodia, zëri i Naim Berishës krijojnë një trinom përfshirës, harmonizues dhe arrijnë ta ngrenë në kreshendo me intonacionin e duhur këtë këngë, e cila shpalos madhështinë e kësaj beteje historike, por edhe të figurës së Dine Hoxhës.

Naim Berisha është një autor i cili ka shkruar poezi lirike, epike dhe tek-

ste këngësh, por ai gjithmonë ka ditur të mbështetet në bukuritë natyrore të trevës së tij e veçmas në folklorin dhe ngjarjet historike, që flasin për qëndresën e malësorëve kundër të huajve.

Vargje të tilla si:

Lum dy Dibrat që të kanë ty/
Dine Hoxha nga një për shpi...të befasojne,
sepse: Jehon Runja e maja e Mollës/
Prej vikamës së Dine Hoxhës...

Vlerësimi që i bën në tekst kësaj figura duket qartë se mbështetet në elementet e formëzimit të ritmit të këngës popullore, dhe tek theksat ritmikë të kësaj kënge, duke alternuar trokai-kun me jambikun aty ku duhet.

Kjo këngë si dhe të tjera si kjo, përçon historinë dhe frymën epike - dramatike e sjell një mesazh krenarie e kujtese për një figurë të kombit që nuk harrohet kurrë.

BETEJA E E DRINIT (KOLESIANIT), PROLOG I PAVARËSISË

(Vijon nga faqja 8)

jendare. Pushkë e flakë nga Qafa e Kolesjanit deri në Kullën e Lumës. Tabe në tabe, gur në gur, lagje në lagje, shtëpi në shtëpi, kudo thirrje:

A besa besë burra për Vatan!...

Në ballin e sulmit ishin vendosur mbi 3000 luftëtarë lumjanë e dibranë. Në krye të tyre qëndronin Ramadan Çajku, Sali Spahia, Suf Xhelili, Xhafer Doda, Osman Lita, Bajram Gjana, Cen Daci, Mer Sufa, Dervish e Nezir Bajraktari, Sul Elezi, Alush Aga e të gjithë bajraktarët trima të Topojanit, Radomirës, Qafë-Kalasë, Çajës, Kalisit, Rrafshës së Lumës e të Tejdrintit. Sulmi i luftëtarëve malësorë ishte i rreptë, por edhe qëndresa e armikut ishte dëshpëruese dhe shumë këmbëngulëse.

Por ortekun e këtyre trimave, që luftonin për mbrojtjen e vatanit, nuk ndalej më. Trimëritë pasonin, nxitnin e plotësonin njëra-tjetrën.

Ranë dhe dëshmorët e parë: Haxhi Ibrahim Gjorgji nga Radomira, Nexhip Dull Visha nga Bicet, Rexhep JonuzTaçi e Selman Asllan Nerguti. Populli i Lumës i përjetësoi ata në këngë, për të mos u harruar në jetë të jetëve.

Lufta vazhdoi gjithë ditën. Shembuj të papërshkruar heroizmi treguan luftëtarët lumjanë e dibranë. Merreshin veprime personale dhe në grup nga më të pabesueshmet, deri në përleshje trup me trup.

Serbët nuk e mbajtën dot as vijën mbrojtëse të parapërgatitur. Tentativat e tyre për rigrupim të forcave të shpartalluara, pothuajse dështuan. Disa sulme që ndërmorën forcat

më të zgjedhura të reparteve serbe, me gjithë ashpërsinë e këmbënguljen e tyre, u thyen keqas nga veprimet e shkathëta e të guximshme të malësorëve trima. E gjithë përpjekja e komandës serbe për të vënë në veprim bateritë e mortajave, tek të cilat mbanin shumë shpresa, dështuan.

Dy topat me qitje të ngadaltë, që drejtoi oficeri artiljer, Cen Daci nga Kalisi, goditën me saktësinë më të madhe, duke nxjerrë jashtë luftimit çdo vendvendosje të tyre.

Në këto kushte, komanda serbe urdhëroi tërheqjen drejt Kullës së Lumës. Por kjo ishte e pamundur tanimë.

Një rrebesh shiu e breshëri i paparë ndonjëherë u derdh mbi Rrafshën e Lumës. Lumi i Shejës, që kalon nga Bicet, u kthye në Drin e Drini në det, tregonin pjesëmarrësit në këtë beteje.

Në përpjekjen për të kaluar Shejën u mbytën më shumë serbë, se sa u vranë në përleshje.

Mëngjesi i 16 nëntorit i gjeti forcat serbe të mbërthyera në darën midis Lumit Sheja e Drinit të Zi. Lajmëtarët trima të Ramadan Zaskocit, gjatë gjithë natës përhapën lajmin e fitores, në ditën e parë të luftimeve, në të gjitha grupimet e luftëtarëve, lagje më lagje e shtëpi në shtëpi, duke filluar nga Kolesjani e deri në Prizren.

Dita e 16 nëntorit ishte ditë kris-mash në të gjithë Rrafshën e Lumës. Drejt Kullës së Lumës ishte dhënë komanda...

Malësorët, tanimë ishin pajisur me mauzerë e xhephane, që ia rrëmbyen hasmit dhe nuk mbaheshin më. Një burim turk thekson-te se: "Brenda 24 orëve, serbët qenë

thyer keqas dhe ishin kapur mbi 1000 mauzera".

Ndërkohë, rapsodi popullor këndonte:

Nëpër flakë lëshohen batore
poshtë te Canet,

Brenda sahatit i zaptuan istikamet,

Morën mauzere, morën topa e xhephanet.

Unaza e rrethimit afrohej drejt Kullës së Lumës dhe armikut po i shtrëngohej laku në fyt. Forcat serbe, të nisura për ndihmë nga Prizreni, me gjithë insistimin e tyre, u bllokuan në Opojë e Gorë nga malësoret e këtyre zonave që komandohehin nga Qazim Lika e Nail Hyseni. Drejt Kullës së Lumës u vunë në veprim pjesët më të zgjedhura të luftëtarëve shqiptarë. Sulmues, çeta dhe prita vepronin në çdo vend, ku armiku mudohej të krijonte rezistencë. Një grup luftëtarësh bllokuan edhe mjetet e transportit, që po tentonin të tërhiqeshin drejt Prizrenit.

Veprimet dëshpëruese të komandës serbe për të çarë rrethimin, duke hedhur në veprim repartet më të zgjedhura të forcave serbe, u neutralizuan e u asgjësuan nga luftëtarët shqiptarë.

Kjo gjendje e forcave serbe pasqyrohet edhe në raportin shpjegues për shkaqet e humbjes, nga komandanti i trupave serbe në këtë beteje: "Sulmi që ndërmori nën-reparti special në krahun e djathtë të Drinit të Zi, nuk arriti t'i dëbojë formacionet shqiptare, të cilat me zjarr nga krahët na shkaktonin humbje të rënda.

Nënreparti i artilerisë malore nuk

arriti të zinte pozicionet e zjarrit... Armiku na qëllonte nga të gjitha fshatrat, nga çdo shtëpi".

Në fund të ditës, nëpër errësi, një pjesë e forcave serbe, që mundi t'i shpëtonte vdekjes, la pas Kullën e Lumës dhe një "kullë të stërmadhe kufomash, armatimesh e municioni bashkë me mallin e madh të urrejtjes kundër murtagjës serbe".

Kështu, përfundoi kjo beteje e lavdishme e triumfit të forcave shqiptare mbi ato serbe, të cilën historiani Shaban Braha, e quan "Termopilen shqiptare" ose "Kaçanikun e dytë".

Beteja e Lumës meriton vëmendjen e duhur nga historiografia jonë kombëtare, pasi ajo pengoi drejtpërdrejt forcat e Armatës së Tretë serbe, duke i gjakosur, rraskapitur e vonuar në realizimin e qëllimit serb, për të dalë në Adriatik e për të bërë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë para Shpalljes së Pavarësisë sonë Kombëtare.

Vargjet lapidare të këngës:

"Djemt e Lumës hiç' s'kan dert,
ka ni luftë e bëjn' përvjet
për vatan s'tremen me vdekë"
transmetojnë në breza Betejën e Lumës, që bashkoi luftëtarët shqiptarë me një besim të patundur në mbrojtje të trojeve shqiptare.

Përmes betejash, si kjo e Lumës, anë e mbanë Vilajeteve Shqiptare u bë e mundur Shpallja e Pavarësisë Kombëtare dhe formimi i shtetit të parë shqiptar më 28 nëntor 1912.

***Studjues - "Bashkëpunëtor i ujetër shkencor" i Institutit të Studimeve historike të Akademisë së Shkencave - Tiranë që nga viti 1978**

PROFILI

QAZIM LAÇI, MËSUESI, QË SI QIRI, U DOGJ DHE U SHKRI PËR DIJE E DITURI

Në Reç midis malesh, përtej Kojzakut dhe sipër përroit të Mallës e poshtë kepit të Lushës, i heshtur, por krenar shtrihet e ndodhet fshati Gjurrë-Reç. Në këtë fshat, përveç fisit të Laçit banonin e banojnë edhe fise të tjerë. Është thënë e thuhej se në fshatin Gjurrë-Reç, dielli lind e bie për hatër të fisit të Laçit.

Shaqir Çerpja

Shumë vite kanë ardhë e kanë shkuar, shumë kohë ka kaluar dhe shumë gjëra kanë ndryshuar. Kanë ndryshuar njerëzit dhe breznitë njerëzore. Nuk kanë ndryshuar vetëm njerëzit, por ka ndryshuar edhe natyra. Ka ndryshuar udha e rrjedhës së ujit të përroit të Mallës. Kanë ndryshuar edhe disa rrugë. Disa rrugë janë zgjeruar, disa rrugë janë ngushtuar dhe disa shtigje janë mbyllur e nuk duken më. Kroi i Mëllezës aty është e aty rrjedh, por dhe ai ka ndryshuar. Aty është edhe kulla trekatëshe e Sul Lushës, por edhe ajo ka ndryshuar, ka mbetur e heshtur dhe e vetmuar. Por në Gjurrë-Reç nuk ka ndryshuar historia dhe lavdia e Gjurrë-Reçit. Nuk ka ndryshuar as kulla trekatëshe, e moçme dyqind e pesëdhjetë vjeçare e Suf Laçit, në të cilën akoma ka jetë e ku jetojnë pasardhësit e brezit të katërt të Suf Laçit.

Në Gjurrë-Reç nuk është shuar mali dhe nuk është harruar emri dhe kujtimi i djalit dhe birit të Reçit, njeriut të drejtë, dashamirës dhe human dhe mësuesit të përkushtuar, të palodhur e të papërtuar, Qazim Laçi, i cili, porsi qiri u dogj dhe u shkri për dije, dritë dhe dituri. Nuk është harruar fati që pati dhe goditja e dënimi që i dha fati. Nuk janë harruar hallet që provoi, dhimbjet që duroi dhe vuajtjet që kaloi.

Ah, ai Qazim Laçi, ... i miri, por fatkeqi! Dhimbjet dhe vuajtjet e tij i ndjeu dhe i përjetoi gjithë Reçi.

Qazim Laçi u lind në vitin 1921, në fshatin Gjurrë-Reç, Dibër. (Por për një gabim të regjistruësëve, në regjistrat dhe dokumentat shtetëror, Qazimi figuron i datëlindjes 1926). Ishte djali i madh dhe fëmija i parë i prindërve Ramadan Laçi dhe Hanishe Shehu (nga Kraj-Reçi). Qazimi u lind në trojet dhe në kullën e madhe të Suf Laçit. Ai ishte nipi i Suf Laçit, por ishte edhe nipi i njeriut të zgjuar e burrit të shquar, me shumë zë dhe emër dhe me shumë reputacion shoqëror e fetar, Imamit Imer Shehu.

Familja dhe tabani familjar i tij ishte baza për formimin njerëzor të tij. Por edhe dajat e tabani familjar i dajave patën rol e ndikuan në formimin e tij.

Familja e madhe dhe kulla e madhe e Suf Laçit ishte me emër e kishte zë, jo vetëm në Reç e Dardhë, Lurë e Arrën, por edhe më larg. Kishte shumë njohje, kishte rreth shoqëror e miqësor të zgjeruar dhe kishte shumë lëvizje, shumë hyrje e dalje njerëzish. Që në moshë të re, Qazimi u shërbente miqëve në dy odat e miqëve në kullën e Suf Laçit. Dhe, kontaktet, takimet dhe komunikimet me shumë njerëz, me miq e dashamirës të familjes së madhe të Suf Laçit, shumë nga këta miq e dashamirës ishin



Kulla 250 vjeçare e Suf Laçit në Gjurrë-Reç (e banueshme edhe sot), ku lindi dhe u rrit Qazim Laçi

njerëz të njohur dhe figura të shquara, disa edhe të arsimuar, të cilët ndikuan në plotësimin e edukimit dhe formimit të tij me traditat tona kombëtare, me dashurinë për vendin, atdheun dhe për njerëzit dhe me ndjenjën e mikpritjes, bujarisë dhe humanizmit.


Krahas punës dhe punëve pranë familjes, tek Qazimi ishte ndez dëshira për shkollë e shkollim. Dhe nxitje e veçantë për këtë dëshirë të tij u bë edhe figura e arsimuar dhe e kompletuar e kushëririt të tij të afërm, Beshir Laçi, i cili, që para çlirimit të Shqipërisë ishte arsimuar në Internatin në Lis të Matit dhe në Burrel dhe në gjimnazin e Shkodrës dhe pas çlirimit ishte bërë njeri e personalitet me shumë reputacion shoqëror e shtetëror. Qazimi e donte shkollën dhe shkollimin dhe me ndihmën e familjes arriti të shkonte, të kryente e të përfundonte shkollën në Internatin e Kastriotit. Pas përfundimit të shkollës në Internatin e Kastriotit, me ndihmën dhe nën kujdesin e dajës së tij, Sali Shehu, shkoi të punonte në Shkup. Qazimi kishte pasionin futbollin dhe kur ishte në Shkup, e kërkojnë dhe futet në skuadrën e futbollit të Tetovës, ku në një ndeshje futbollit dëmtohet rëndë në gju dhe i nënshtrohet një operacioni në spitalin e Shkupit. Pas çlirimit zgjidhet sekretar rinie për gjithë zonën e Reçit, por edhe sekretar rinie për organizatën e rinisë aksioniste në hapjen e rrugës automobilistike Kukës-Peshkopi.

Në vitin 1946 hapet shkolla fillore në Gjurrë-Reç dhe Qazimi, bashkë me kushëririn e tij Sadik Laçi fillojnë e punojnë mësues në këtë shkollë. Pas një viti, në vitin 1947, me orientimin dhe ndihmën e Beshir Laçit, i cili ishte

kryetar i komitetit ekzekutiv në Peshkopi, Qazimi shkon në kursin metodik nëntëmuor në Shkodër. Menjëherë pas mbarimit të kursit, caktohet e punon mësues në Ushtelenxë, ku gjeti një ambient të ngrohtë, bujar dhe shumë miqësor e mikpritës. Edhe tani, familjarët e Qazim Laçit, me shumë mirënjohje dhe respekt, kujtojnë familjen e Ramadan Hoxhës, ku Qazimi jetoi bashkë me familjen e tij dhe hëngri bukë në një sofër me familjen e tij. Më pas, Qazimi punoi mësues edhe në Lashkizë, në Gjurrë-Reç, Ndërshenë, Arrmollë, Draj-Reç, Tejmollë dhe përsëri në Gjurrë-Reç.

Ai ishte shumë njerëzor, e njihhte botën e fëmijëve, futej e jetonte në botën e tyre dhe me ngrohtësi e dashuri prindërore bisedonte me fëmijët, u shpjegonte dhe luante e këndonte me ta. Ishte i qetë, i qartë dhe i kuptueshëm. Kudo punoi me ndërgjegje dhe përkushtim maksimal shpirtëror, mendor, fizik e profesional. Ai ishte i përkushtuar maksimalisht për të përmbushur misionin fisnik të mësuesit dhe objektivat për të realizuar në shkollë sa më të lartë përvetësimin nga nxënësit të programit mësimor dhe edukativ.

Karakterit dhe shpirti i tij përshkohej nga zemërbardhësia dhe humanizmi. Krahas punës për realizimin cilësor të procesit mësimor dhe edukativ, ai përpigjej, punonte dhe luftonte maksimalisht për të mbajtur gjallë, për të kultivuar dhe forcuar ndjenjën e dashurisë për traditën dhe kulturën kombëtare. Ai me shpirt, me zë e zemër dhe me punë e vepra përcolli e përçoi nevojën që të gjithë të punojmë e të kontribuojnë maksimalisht për vendin, atdheun dhe vendlindjen. Bota shpirtërore dhe men-



Qazim Laçi

dore e tij ushqej nga dashuria për vendin dhe vendlindjen. Ai admironte çdo gjë që kishte erën dhe aromën e vendlindjes: historinë, natyrën, malet e bjeshkën, peisazhin, arat dhe livadhet, bjeshkët dhe stanet, gurët dhe krojet, udhët e shtigjet, lulet dhe pemët, deri edhe shkozën dhe frashërin, mëllezën, thanat dhe boshttrën në Stërpalaj, në shpatin e Pojeve dhe poshtë majes së Rrasës.

Qazim Laçi, përveçse ishte njeri me cilësi dhe vlera e vrytite të spikatura, ai ishte dhe mësues i kualifikuar dhe i përkushtuar për punën dhe profesionin. Por ishte dhe intelektual vizionar me horizont të ndriçuar nga dijet dhe dituria, i cili punoi e ndikoi edhe në zhvillimin kulturor dhe emancipimin shoqëror të njerëzve. Ai kishte shumë dëshira, ëndërra dhe shpresa për jetën. Por ai nuk mundi ta jetonte jetën ashtu siç donte, ëndërronte e shpresonte. Në vitin 1970, në kulmin e jetës dhe të karrierës profesionale, tamam atëherë kur kishte krijuar stabilitet ekonomik dhe përvojë dhe siguri profesionale, fati e goditi rëndë dhe shëndeti i tij u prek dhe u trondit rëndë nga një sëmundje e rëndë, e gjatë dhe e pashërueshme, gangrena. Për shumë vite, nëntë vite me radhë, ai u lodh dhe u stërmundua, u dergj nëpër spitale në Peshkopi, Tiranë e Durrës, por shëndeti i tij nuk u përmirësua, por përkundrazi, nga viti në vit, nga muaji në muaj dhe nga dita në ditë, sëmundja agravonte e shëndeti i tij vetëm përkeqësohej. Qazim Laçi u bë pacient i përhershëm i reparteve spitalore të kirurgjisë në Peshkopi, Tiranë e Durrës. Jo pak, por plotë tetë herë u operua dhe operim pas operimi, ai mbeti pa asnjë gjymtyrë, pa këmbë, pa duar dhe pa krahë.

Sa e rëndë! Sa dhimbje! Sa vuajtje! ... Dhimbja nuk kishte qetësi, vuajtja nuk kishte fund. Shpresat ishin ngurtësuar dhe kishin mbaruar.

Jeta e tij ishte një provë e sprovë e madhe dhe shumë e vështirë. Dhimbjet dhe vuajtjet e tij ishin dhimbje e vuajtje edhe për familjen e të afërmit e tij: për

(Vijon në faqen 11)

PARA 8 DEKADAVE

Shqiptarët u rreshtuan në anën e drejtë të historisë

Nga Bashkim Hisari

Duke qenë pjesë active në luftën kundër pushtimit nazifashist, shqiptarët u rreshtuan në anën e drejtë të histories dhe luajtën një rol të rëndësishëm. Në këtë luftë, edhe pala shqiptare e Kosovës organizoi lëvizjen partizane dhe me rreth 55 mijë luftëtar u rreshtua përballë kësaj luftes kundër nazifashizmit. Fadil Hoxha ishte themelues kryesor i aradhave partizane që organizuan rezistencë e armatosur kundër forcave pushtuese dhe figurë të rëndësishëm në luftën për çlirimin e Kosovës.

Në nëntor të vitit 1944, Kosova u çlirua nga pushtimi nazifashist, kryesisht falë përpjekjeve të lëvizjes partizane në Kosovë dhe Shqipëri.

Tani pas tetë dekadave duke evokuar këto ngjarje historike duhet të konstatojmë se viti 1944 – ishte vit epokal të thyerjeve dhe kthesave në historinë moderne të njerëzimit. Rëmia e nazifashizmit së bashku me regjimet totalitare fituan reputacionin djallëzi e shërbimit për të keqën. Me përdorimin e mjeteve të industrisë së vdekjes, mënyrat e kryerjes së krimeve masive, numrin e viktimave, motiveve dhe ideologjinë tentuan të çonin në shkatërimin njerëzimit.

Në imazhet themelore të disfatës së nazifashizmit, u shprehën tiparet e fenomenit të luftës totale më të përgjakshme më të tmerrshme, të dhunës më barbare në një epoke që “shpiku” dhomat e gazit, kampet e gjenocidit, torturimet, poshtrimet, likvidimet e miliona partizanëve dhe qytetarëve civil si dhe krimet dhe shkatërrimet tjera që në historinë njerëzore nuk mund të imagjinohehin deri atëherë.

Në këtë sfond, fitorja ndaj nazifashizmit para 80 viteve kishte statusin e një “pikë kthese”-një kthesë për mirë, drejt frenimit të atyre forcave barbare që përqëndroheshin në ideologjinë e nacionalizmit ekstrem, superioritetin racor, gjenocid, autoritarizëm total, në ideologjinë e urrejtjes dhe ksenofobisë që shkatruan shumë vlera materijale kulturore historike të krijuara nga brezat njerëzorë ndër shekuj. Ndaj, evokimi për fitoren shkon përtej gjestit të përkujtimit të zakonshëm ritual të 80 vjetorit të ngadhënjimit. Mjerisht, kohëve të fundit po praqiten disa individë të përfshirë në rrëshqitje që po mbështeten në


dokumente dhe burime të thata të falsifikuara dhe në rutinën “shkencore” të tyre dhe biejn daullit të shpuar pa gjë.

Lufta Nacionalçlirimtare dhe disfata e nazifashizmit para 80 viteve është ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Në horizontin e jetës historike të kohës, fitorja nuk mund të jetë fakt i ngurtësuar, i zhveshur, nga historia e mbyllur. Nuk mund dhe nuk duhet të jetë, plastike, që rrjedh, lëkundet, si përpara ashtu edhe prapa dhe fundoset. Është një arritje dhe sukses i madhe i forcave liddashëse e paqdashëse, progresive e demokratike edhe të shqiptarëve në luftën kundër forcave të errëta nazifashiste.

Idetë dhe idealet e luftëtarëve Kosovar u bënë të dukshëm në Konferencën themelore të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dugagjinit në Bujan. Dokumentet e Bujanit kishin rëndësi të madhe historike sepse për here të parë në një Kuvend që u zhvillua ende pa u fikur flaka e luftës, u kërkuar të respektohet dhe të njihet e drejta e shqiptarëve për vetëvendosjes deri në shkëputje dhe realizimi i dëshirës së tyre shekullore për bashkim me Shqipërin, një e drejtë e natyrshme dhe e patjetërsueshme që rezultonte nga pjesëmarrja në Luftë Nacionalçlirimtare dhe garantohej me dokumente të njohura ndërkombëtare. Populli shqiptar i Kosovës besonte fortë se do të realizohet e drejta e tij për liri, barazi, vetëvendosje dhe bashkim me shtetin amë Shqipërinë. Por, vendimet e Bujanit u mohuan u shkëlqen dhe më në fund u përjashtuan dhe u refuzuan nga forcat nacionaliste shoveniste serbe.

Pas Luftës së Dytë Botërore, bartësit e zhvillimit politikë, ekonomik, social, arsimor, kulturor dhe jetësorë në Kosovë ishin luftëtarët shqiptar të shkolluar dhe ideogjikisht të formuar në Shqipëri. Ndonëse zhvillimi i Kosovës ishte i kufizuar për shkak të represionit politik dhe diskriminimit ndaj shqiptarëve, ata megjithatë afirmuan vlerat e pamohueshme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ishin figura qendrore dhe faktorë institucionalë që kontribuan në këto procese.

Fadil Hoxha që mbajti pozita më të rëndësishme në strukturat e Jugosllavisë luajti një rol kyç në përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të Kosovës. Ai politikisht dhe moralisht ishte i vendosur të luftoj për pikëpamjet e popullit.



• Pas Luftës së Dytë Botërore, rënia e nazifashizmit, ishte ngjarja më e rëndësishme në historinë e njerëzimit që paralajmëroi marrëdhënie të reja gjeopolitike, sisteme të reja politike dhe një rend të ri botëror

Më vitin 1983 deklaroi: “Kam luftu për Shqipëri, e për Jugosllavi një plum nuk e kisha shprazë”. Në kohën kur filloi të luhaten shtyllat e Jugosllavisë,

u zhgjua nacionalizmi dhe shovinizmi serbomadhi dhe stuhija kundër shqiptarëve u ngrit në një shkallë më të lartë deklaroi: “Pa çlirimin e shqiptarëve të Kosovës nuk do të ketë qetësi në këto anë. madje as në Jugosllavi, as në Shqipëri e as në Ballkan “Fadil Hoxha fuqimisht përkrahu luftën e UÇK- së dhe ngriti zërin duke thënë: “ Po të isha i ri, përsëri do t’i mbathja opingat dhe do të dilja në UÇK”

Në vitet 1998-1999, Serbia kreu fushatë të dhunshme kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, duke shkaktuar ndërhyrjen e NATO-s dhe përfundimisht çlirimin e Kosovës.

Në vitin 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj, por Serbia kundërshtoi ashpër këtë shpallje dhe Kosovën konsideron si pjesë të territorit të saj. Serbët vazhdojnë t’i interpretojnë interesat e tyre kombëtare në të njëjtat koordinata që ishin vendosur në të ashtuquajtur “Memorandumit ASHA e Sërbisë dhe

të palitikës së Millosheviqit gjatë viteve nëntëdhjetë. Theksojnë se jeta e serbëve në Kosovë është e kërcënuar, meqë sipas tyre “krahina jugore serbe është shkëputur paligjshëm nga ekstremistët dhe terroristët shqiptarë”

Realizimin e interesave kombëtare, serbët e shohin në vendosjen e marrëdhënieve sa më të ngushta me ato forca që kundërshtojnë njohjen e Kosovës, në radhë të parë me Federatën Ruse, Republikën Popullore të Kinës dhe vendet e botës së tretë. Në krye të asaj kolone të “lavdishme patriotike”, siç u pëlqen të bëjnë lajka, janë përfaqësuesit e regjimit aktual dhe të partisë në pushtet në krye me Aleksanda Vuçiq që këndojnë lavdërimet për oficerët të lartë serb, që u dënuan për krimet më të rënda kundër njerëzimit. Me fanatizëm të jastëzaonshme e me patriotizëm të rrejtshëm përsërisin atë histori boshe se në asnjë kusht nuk do të pranojnë pavarësinë e Kosovës dhe nuk do të lejojnë të anëtarsohet në OKB. Beogradi zyrtar mbështet grupet terroriste serbe të cilët në veri të Kosovës kryen vepra të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës. Nuk pranojnë se kanë kryer gjenocid në Srebrenicë që u përcaktua nga vendimet e gjykatave të OKB-së, si dhe gjykatave në Bosnjë e Hercegovinë. Blokojnë zbatimin i marrëveshjeve që rrjedhin nga dialogu politik të Kosovës dhe Sërbisë ndërmjetësuar nga BE.

Por Kosova tani sa vite është çliruar dhe ka krijuar shtetin e lire dhe më vete dhe synon antarsimin në strukturat euroatlantike. Për hire të ardhmëris ngren zërin kundër të gjitha këqijave shoqërore politike, shtetërore e të tjera.

Zjarrin që Serbia po përpiqet të ndezë, Kosova do ta shuaj, vetëm përmes negociatave, me mjete paqësore, demokratike, me mençuri politike diplomatike dhe me mbështetjen e aleatëve strategjik ndërkombëtar.

QAZIM LAÇI, MËSUESI, QË SI QIRI, U DOGJ DHE U SHKRI PËR DIJE E DITURI

(Vijon nga faqja 10)

nënë Hanishen, për bashkëshorten Xhilen dhe fëmijët e tyre, për vëllain Asllanin dhe motrat, por edhe për dajat dhe të gjithë ata që e njihnin.

Por Qazim Laçi ishte shumë trim dhe shumë i fortë. Vuajtja e madhe dhe e gjatë e kishte forcuar shumë. Çuditërisht, edhe në atë gjendje, vetëm trup pa gjymtyrë, pa këmbë, pa duar dhe pa krahë, ai buzëqeshte, komunikonte ëmbël dhe me shumë dashamirësi dhe gjithmonë përcillte mirësi dhe forcë e fuqi. Jeta e tij e vështirë, përtej dhimbjes dhe vuajtje ishte dhe është një mësim, vinte e vjen si testament se

dhe fati i keq duhet pranuar dhe jeta e egër duhet jetuar, ashtu si të vij, edhe me dhimbje e plagë, me vuajtje e vështirësi. Në gjithë jetën e tij të vështirë ai diti të qëndronte dhe qëndroi vertikal, si kulla e moçme trekatëshe e Suf Laçit, ku ai lindi dhe u rrit.

Pas nëntë vjetësh dërgie në shtrat, nëpër spitale e salla operacionesh, më 24 maj 1978, Qazim Laçi mbyll sytë përgjithmonë.

Qazim Laçi, ky njeri dhe mësues me shumë vlera, meriton fjalët më të përzgjedhura e më të ndjera. Por nëpërmjet këtij shkrimi nuk mund të ndriçohen, të përshkruhen dhe të thuhet e të tregohen të gjithë vlerat njerëzore dhe përkushtimi dhe saktificat e tij njerëzore, familjare dhe profesionale për punën, për shoqërinë, për vendlindje, vendin dhe atdheun. Qazim Laçi, porsiqiri u dogj dhe u shkri, për dije, dritë dhe dituri.

PËRURIMI

Më datën 19.10.2024 në Qafë të Skërficës është përruruar “shtëpia” e dëshmorëve që luftuan 110 vjet më parë

MEMORIAL PËR DËSHMORËT NË PORTËN E PARË TË LABËRISË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në përrurimin e “shtëpisë” së e dëshmorëve që luftuan 110 vjet më parë në Qafë të Skërficës, merrnin pjesë miq e dashamirës të shumtë nga Qarku Gjirokastrë e Vlorë, deputetë të Parlamentit Shqiptarë, Kryetari i Gjykatës së Lartë Sokol Maliq Sadushi, deputeti Petro Koçi e Vullnet Sinaj, Dino Selimi, Tërmet Peçi, Ardi Veliu, Ardit Bido, Prof. Rami Memushaj, Irfan Bilbilaj, Profesor Bernard Zotaj që përfaqësonte edhe Kryetarin e Labërisë Agim Çiraku, Arben Bllaci, Flamur Hasimi që përfaqësonte edhe Kryetarin e OKDA Dr. Gjergj Velo, MSC Behar Salillari nga Departamenti i Dëshmorëve në MM, Dr. Gjergj Bizhga, Dr. Arnold Pashaj, Abaz Goxhaj, klerikë të shquar Hysen Shehu, Dervish Mikel Onjea, Dervish Ermal Hoxha nga Krahësi, Dervish Hetem Resuli nga Koshtani, Mareglen Basho, Gazmend Allkja, Luan Muca, Ëngjellush Bellaj, Mitat Bellaj, Alush Kërra, Astrit Muho, Sefer Muho, dhe anëtarë të SHKA “Fushëbardha”, SHHUSH, SHAK “Labëria”, Shoqatat “Vajzë”, “Dukaj”, “Kallarat”, “Dr. Bilal Golemi”, “Lunxhëria”, Organizata e Dëshmorëve, veteranëve, Dega e Labërisë së Sarandës, grupet polifonike të Fushëbardhës dhe Zhulatit, etj., që morën pjesë dhe nderuan në përrurimin e memorialit të Skërficës dhe përkujtimin të nëntë dëshmorëve të rënë në luftën e skërficës më 20 deri më 25 Qershor 1914. Merrte pjesë edhe e dërguara e posacme e Kryetarit të Bashkisë së Delvinës Besmir Veli, znj. Erinda Seitaj njëherazi edhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të Delvinës, të dërguar të posaçëm të kryetarit të Bashkisë së Gjirokastrës Flamur Golemi, por edhe mjaft pjesëmarrës nga Krahina e Kardhiqit, Rëzomës, Delvinës, Sarandës, Gjirokastrës; ndërsa organizatorët ishin nga SHKA “Fushëbardha”, Nexhip Onjea, Zaho Golemi, Trifon Golemi, Pajtim Bello, Dervish Mikeli, Hoshho Onjea, Angjelo Kazo, Teli Resuli, Ana Kazo, Adriatik Cama. Memoriali i Skërficës i hap rrugën memorialit të ri që do bëhet në Senicë për 5 dëshmorë).

Përkujtohet lufta e përgjakshme që u zhvillua më shumë se një shekull më parë në Qafë të Skërficës, në qafën që ndan e bashkon Gjirokastrën me Delvinën, në qafën që konsiderohet një ndër portat e Labërisë, që ka pritur e përcjellë përmes këtyre shtigjeve në shekuj bij të Labërisë që shkoni e vinin luftrave në mbrojtje të truallit arbëror. Lufta e Skërficës është ngjarje më madhore e 110 viteve më parë, një luftë e përgjakshme një javore që ka ngelur në memorien e shqiptarëve si qëndresë luftarake dhe mbijetesë në mbrojtje të truallit shqiptar, të Labërisë.

Skërfica, Fushëbardha, mbarë fshatrat e Labërisë dhe më gjerë kanë qenë dhe kanë mbetur një nga gjëmimet e shumta luftarake të historisë shqiptare dhe më të përgjakshme që tashmë studjohet edhe në Akademinë Ushtarake shqiptare. Lufta e Qafës së Skërficës u zhvillua pas kuvendit të Shtëpëzimit të 10 prillit 1914, në kohën kur nisi mësimja masive për të shfarosur jugun e Shqipërisë, të pabindur ndaj qeverisë autonomiste të Zografos, betejës së Cepos e masakrave të shumta në të gjithë jugun e vendit tonë. Është fakt se për këtë luftë të përgjakshme u mobilizuan gjithë resurset e mundshme materiale luftarake e njerëzore të shqiptarëve.

Fakt ishte se gjithë Jugu i Shqipërisë ishte në luftë. Për luftën e Skërficës mobilizimi ishte maksimal dhe organizatorët ishin banorët e Fushëbardhës, ku i ra për pjesë mbrojtja e fshatit por dhe gjithë Labërisë për ti shpëtuar vrasjeve dhe djegieve masive të andartëve të pamëshirshëm. Fakt është se për këtë luftë çeta e Fushëbardhës doli në frontin e saj në Skërficë me luftëtarë të udhëhequr nga kryeplaku dhe komandanti i çetës së Fushëbardhës Halil Sullo, por luftuan edhe luftëtarë nga Delvina, Gjirokastra, Krahina e Rëzomës, Krahina e Kardhiqit, Libohova, Çamëria etj. Porta e Labërisë nga ana jugore ishte hyrja nga Luvadhë në Skërfica drejt Fushëbardhës. Skërfica ishte një luftë lokale, ku fqinjët tanë synonin jugun e Shqipërisë, shfarrosjen e një popullate autoktone që jetonte në truallin mijëraveçar. Kjo çoi fqinjët jugorë drejt objektivit strategjik të vjetër, ku ushtria bashkë me andartët shkaktuan shkatërrime masive, masakra e barbari të panjohura. Lufta në Skërficës nuk është një betejë e shkëpu-



tur e vitit 1914. Ajo është vijimësi qëndrese e nisur në frontin e kryeqendrës së vilajetit Janinës si dhe në frontet e tjera të luftës. Në Skërficë foli gryka e pushkës, por edhe me gurë dhe me çfarë të mundnin çeta e Fushëbardhës më 20 qershor 1914 dërgoi një postë të përparuar zbulimi me 12 luftëtarë tek Gurët e Bashe, që kryenin zbulim mbi kampin andart të vendosur në Qafë të Luvadhë.

Ishin këta 12 luftëtarë që ndezën të parët qëndresën. Çeta u rrit me shpejtësi nga 40 vetë vetëm në pak orë në rreth 120 luftëtarë, me komandant Halil Sullo ish-kryeplak dhe komandant i çetës që shkroi histori qëndrese deri në largimin e fshatrave drejt Vlorës. Agrosorët me 450 andartë e ushtarë, të drejtuar nga shtabi madhor i vendosur në Jorgucat e Delvinë. Kjo forcë mbështetej edhe nga 1500 andartë të skalionuar, të pajisur me armët më moderne të kohës përfshi artilerinë. Batalioni me andartë e ushtarë dhe major Korjaskonis, e mbylli me turp karrierën në Skërficë përballë trimërisë labe dhe jo vetëm. Shtabi madhor akademik i fqinjëve, i pajisur me taktika, strategji, armatime e topa dështoi kundër kryengritësve popullorë të formuar në “akademinë” e betejave popullore. Në Skërficë i thanë “ndal!”, grabitjes së tokave arbërore, në një pozicion strategjik natyral, si një xhephane lufte, ku shqiptarët kishin pritur me jatagan dhe me pushkë pushtuesit në gjithë epokat dhe shekujt. Në mbështetje të frontit të luftës së Skërficës ishin burra, gra, pleq, dhe fëmijë, të drejtuar nga trimi, kryeplaku luftëtarë e organizatori Halil Sullo, të vendosur për mbrojtjen me çdo kusht të Qafës së Skërficës deri në largimin e kreyt popullatës së fshatrave që andartët kishin vendosur ti digjinin plotësisht dhe të shfarrosnin çdo frymorë të kësaj zone.

Forcat andarte depërtuan në shtigje të fshehtë të Skërficës në drejtim të Pilloit, që ishte edhe një ndër faktorët e përshpejtimin të tërheqjes drejt Vlorës të popullatës. Qafa e Skërficës u kthye në istikam qëndrese të përgjakshme. Artileria shkëmbore e përdorur me aq mjeshtëri në periudha e kohë të ndryshme në Shqipëri, u përsërit edhe në Skërficë. Drejtimi i Gjinishtës dhe Vrahollit u kthyen në kala qëndrese nga ku rrokulliseshin gurët masivisht nga vëllezërit Dervish, Hadër e Medi Yzeiri dhe luftëtarë të tjerë. Përgjakja një javore përfundoi me rënien në fushëbetejë të shumë dëshmorëve, një humbje të konsiderueshme me 9 luftëtarë shqiptarë të vrarë dhe 60 të plagosur; ndërsa forcat andarte lanë në Skërficë rreth 60 të vrarë dhe rreth 120 të plagosur. Garantimi i tërheqjes së banorëve të fshatrave në drejtim të Vlorës, u realizua pasi andartët depërtuan përmes “kalit të Trojës”, nga mali i Pilloit, në Qafën e Skërficës. Kështu që luftimi vijoi nga njera llogore në tjetrën në thellësi. Kameniku, Vraholl, Gurët e Bashe, Gropa e Dërrasës, Qafa e Skërficës u kthyen në kala qëndrese natyrore të pakapërcyeshme pushtimi. Fushëbardhas dhe bashkëkrahinas nga Krahina e Kardhiqit dhe Rëzomës shkruan epope trimërie dhe rikonfirmuan atë që shqiptarët nënshkruanin për lirinë në bete-

ja me gjak heroizmi. Lajmërimet për tërheqjen e popullatës drejt Vlorës e transmetonte Komandanti i çetës nëpërmjet korierit të luftës së Skërficës Cenko Onjea. Ditë e natë gjithë mbështetja e popullatës ishte për luftën, për frontin e Skërficës. Ndërkohë ishte vrarë edhe dëshmori 22 vjeçar Cenko Onjea në lëndinë të blertë të Qafë Dardhës sipër Fushëbardhës. Por çeta vijoi të luftonte kundër andartëve dhe ushtrisë me një qëndresë të pashembullt historike duke luftuar trimërisht, pa mbështetje të strukturave qeveritare, kur qeveria e Ismail Qemalit kishte dhënë dorëheqje që në janar 1914, por edhe pa mbështetje të Qeverisë së Vidit dhe as ushtarakëve të xhandarmërisë hollandeze që ishte prezent në vendin tonë, ku mund të themi që edhe sabotimi i luftës së shqiptarëve bëhej nga Tomsoni që bënte pakt me grekët në marrëveshjen e Korfuzit.

Kërcënimi i Skërficës që ishte edhe një ndër pesë portat hyrëse të Labërisë, ishte serioz dhe u mbrojt vetëm me gjak. Në flakë u ndezën Shpella e Dhespinës, Shkëmbi i Kaze, Nomeja e Qershisë, Përroi i Shametit, Qafa e Trullave, Gropa e Dërrasës, Vrahull e deri në Qafë të Skërficës. Tashmë historia e rënies së dëshmorëve është e dokumentuar dhe shkruar në memorien e Labërisë dhe gjithë shqiptarëve: Halil Sullo komandanti i çetës që u vra në hyrje të Shkëmbit të Skamanos; Dalip Kondi u plagos rëndë në të majtë të qafës së Skërficës sipër projt të sipërm e shkoi në drejtim të “Përroi i Shametit” dhe vdiq tek piksaret, eshtrat e të cilit janë gjetur pas tre vjetësh në sipërfaqe bashkë me pjesën metalike e pushkës; Mete Jonuzi ra heroikisht tek Kroi i Resule, pranë Gurëve të Bashe; Sejdi Baho u plagos rëndë në “Gropën e Gjeshtrës” dhe ndërroi jetë në spital në Tepelenë; Rizal Muho u vra tek Nomeja e Panjës mbi Kamenik, ku për një shekull vendi i rënies u thirr “Lisi i Rizal Muhos”; Halil Norra u vra në Qafë të Skërficës, në të djathtë të kroit të sipërm të Skërficës (kur e shikon nga Qafa e Luvadhë nga ana jugore); Surja Tefa i plagosur rëndë luftoi trimërisht në Qafën e Trullave me mauxer dhe nagant, pa u dorëzuar dhe kur jeleku ishte mbuluar me gjak lufton deri në vdekje e nuk dorëzohej edhe nga torturat çnjerëzore të andartëve. Në xhephanen e Cepos ra dëshmor Haxhi Muxhai nga Zhulati dhe sa e sa djem ngta gjithë jugu i Shqipërisë.

Dëshmorët e Skërficës janë në panteonin e përjetshëm të mirënjohjes së kombit, por lufta kishte edhe dhjetra të plagosur si Murat Cama, Hadër Uzeiri, etj., të cilët pas shërimit të plagëve morën pjesë dhe në Luftën e Vlorës më 1920. Në Skërficë nuk u bë pakt me dredhinë, nuk u kërkua “besë” nga pabesia. Lufta ishte e ashpër edhe më në thellësi të Labërisë, në Zhulat, Golem e deri në Kuç, Kallarat, Bolenë, Borsh, Llogora etj. Shqiptarët u trupëzuan me qafën-kala natyrore të Skërficës, dhe ngelën në panteonin e kombit dhe në memorien popullore. Dëshmorët janë dhëndurrë lirie në panteonin e kombit, janë në kujtesën shqiptare dhe janë në lapidar përjetësisht në Skërficë dhe në Fushëbardhë. Memoriali-lapidar që ngrii fshati Fushëbardhë me brigadën e saj të ndërtimit të viteve 70-të të shekullit të kaluar nuk u la në harresë. Gjaku i dëshmorëve që ranë në këtë betejë në në Luftën e Skërficës (20.6.1914 deri 25.6.1914) mbetetet një apel për mospërsëritje të kësaj historie të hidhur. Fushëbardha gjithë treva përreth, Labëria nuk mund të harrojnë gjakun e derdhur. Kjo luftë ka hyrë në axhendën kombëtare të studimeve historike ushtarake të luftrave të popullit shqiptar kanë rënë 9 dëshmorë: Halil Sullo (1864 -1914), Halil Norra (1886 -1914), Surja Tefa (1887 -1914), Rizal Muho (1889 -1914), Sejdi Baho (1889 -1914), Dalip Kondi (1892 -1914) Cenko Onjea (1892 -1914), nga Zhulati Haxhi Muxhai (1883 -1914), dhe nga Golemi: Mete Jonuzi (1887 -1914). Fiset e tyre jetojnë sot edhe në trevën e bashkisë së Gjirokastrës, Delvinës e më gjerë. Poeti, atdhetari, luftëtar dhe doktori, që lidhi plagët e luftës në Skërficë Ramiz Harxhi para më shumë se një shekulli do të shkruante në SHBA: “..Të pavdekur janë gjithë ata luanë,/ Për nder të kombit u grin’e u vranë...”. Këngët për Qafën e Skërficës të pagëzuar tashmë si Qafa e

PERSONALITETE

Shpendi dhe Spartak Topollaj energjitë e tyre fizike e shpirtërore ia kanë kushtuar atdheut dhe popullit

DY PERSONALITETE TË SHQUARA TË SHOQËRISË SONË...

Nikolla SUDAR*

Në çdo epokë të shoqërisë njerëzore ata janë vlerësuar dhe kanë fituar edhe përjetësinë. Sapo lexova kushtimin e shkrimtarit dhe mikut tim të vjetër, z. Kadri Tarelli, kushtuar njërit prej krijuesve më të arrirë në letërsinë e sotme shqipe, shkrimtarit të shquar dhe mbi të gjitha “njeriut të mrekullueshëm”, z. SHPENDI TOPOLLAJ, si për prodhimtarinë bollshme, por sidomos për atë tematikë të larmishme dhe tepër cilësore, që sot, më tepër se kurrë, ka nevojë shoqëria shqiptare.

Shpendi Topollaj u lind më 1947. Babai i tij, veterani, juristi dhe shkrimtari Hulësi Topollaj, ishte nga Novosela e Kolonjës, kurse e ëma Hatijeja, ishte nga fisi i dëgjuar për atdhetari i Agallinjve në Vlorë. Me të përfunduar shkollën shtatëvjeçare, nis studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, të cilën e mbaron në vitin 1964. Më tej vazhdon shkollën e Bashkuar të Oficerëve, dhe në vitin 1966 titullohet oficer këmbësorie dhe emërohet në Durrës si komandant batalioni. Por duke qënë se i ati i tij goditet rëndë, si bashkëpunëtor i “grupit puçist të Petrit Dumës”, ndëshkohet me pretekstin se ka lexuar një libër me kritika letrare të prof. dr. Rexhep Qosjes dhe degdiset në një repart të largët, ku qëndron i harruar për rreth njëzet vjet. Ndërkohë ai kryen fakultetin juridik, por iu përkushtua me pasion edhe letërsisë, artit, historisë etj. Me gjithë vështirësitë e njohura, Shpendi ishte nga të parët kuadro të ushtrisë që mbështeti me entuziazëm proceset demokratike në vend. Duke parë aftësitë e spikatura të tij i jepet grada nënkolonel dhe emërohet shef i Mbrojtjes Civile të rrethit të Durrësit. Pas largimit nga ushtria, caktohet në detyrën e Shefit të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore në Këshillin e Rrethit. Ai bëhet promotor i organizimit dhe zhvillimit të dhjetëra veprimtarive, kushtuar figurave të shquara, të goditura dhe lënë qëllimisht në hije apo të promovimit të krijimtarisë letrare të autorëve të ndryshëm, sidomos durrsakë. Mbas suprimimit të seksionit që drejtonte, kryen detyrën e Përmbartuesit gjyqësor, gjersa doli në pension.

Shpendi nuk ka reshtur së kryeri dhe detyrat shoqërore, si anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, aktivist i një sërë organizatash të tjera shoqërore, dhe është zgjedhur Ambasador i Paqes. Të panumërt janë ata që që flasin fjalët më të mira për këtë intelektual të vërtetë, që me përkushtimin ndaj njerëzve, për shpirtmadhësinë unikalë, është shndërruar në simbol për të gjithë brezin tonë të sotëm. Në një bisedë private me “Nderin e Kombit”, të paharruarin gjeneral Rrahman Parllaku, simbol i ushtarakut të denjë shqiptar, ndër të tjera është shpreur:



Z. Shpendi Topollaj në një event të shoqatës së mirënjohur “Tirana”



Diplomati dhe analisti i shkëlqyer Spartak Topollaj

“Jeta me përpiceitë e papritur të saj më ka mësuar të njoh mirë njerëzit dhe në këtë drejtim nuk kam gabuar asnjëherë. Në mesin e miqve të mi dinjitozë bën pjesë edhe fisniku model, Shpendi Topollaj, njeriu që me të vërtetë meriton vlerësimin më të lartë njerëzor. I dashur i thjeshtë, plot temperament dhe mbi të gjitha një optimist i rrallë, i gatshëm për çdo sakrificë, të tillë e njoh mikun tim të nderuar”.

Pas viteve nëntëdhjetë ai fillon të shkruajë (për arsye biografike, i privuar nga diktatura si krijues për dekada me radhë, do të shpërthente me të gjitha forcën gjenia krijuese e akumuluar e këtij intelektual të mirëfilltë), që, sipas mendimit tim, është më prodhimtari cilësor në letërsinë e sotme bashkëkohore shqipe. Ai vazhdon të lëvrojë me sukses pothuajse të gjitha zhanret e letërsisë, si poezi, tregime, novela, romane, publicistikë, kritikë letrare etj. Qindra artikuj ka shkruar e botuar në shtypin e kohës, madje edhe për problemet akute të kohës, gjë që e ka bërë të njohur kudo. Shumë nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, janë botuar jashtë shtetit dhe janë vlerësuar shumë nga kritika e specializuar e lexuesit. Për të dhe krijimtarinë e tij, janë botuar librat voluminozë “Të shkruash në liri – Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu”, dhe “Liria e të shkruarit”. Ai është vlerësuar shumë lart për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga penat tona më të njohura. Kritiku Kostaq Xoxa shkruan:

“Autori i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pasdiktaturës, Shpendi Topollaj, të befason me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezitë, në tregimet, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin, e thesareve të lashtësisë...”

Vlerësimi dinjitoz i ardhur nga India e largët i

bën nder jo vetëm këtij krijuesi të rrallë, por gjithë letërsisë sonë bashkëkohore, duke e lartësuar akoma më tepër emrin e mirëtë Shqipërisë nëpër botë. Para pak kohësh Presidenti i Republikës e nderoi intelektualin e shquar Sh. Topollaj me urdhëri “NAIM FRASHËRI” i artë.

Në vazhdim të këtij vlerësimi e meriton që të përmendet me respektin më të madh edhe diplomati i shquar Spartak Topollaj, vëllai i z. Shpendi Topollaj. Ai u lind në Tiranë, në vitin 1950, ku edhe është diplomuar për histori- gjeografi. Gjatë karrierës së mësuesisë ka punuar në gjimnazet e Peshkopisë e të Rrëshenit, në filialin e universitetit të Shkodrës dhe në universitetin e Arteve në Tiranë.

Gjatë kthesës së madhe të viteve 90, u bë njëri nga iniciatorët e lëvizjes demokratike në Peshkopi. Ai është specializuar për histori moderne në Itali, Francë dhe SHBA. Aktiviteti i tij do të shkëlqente edhe në diplomaci si Shef i Misionit Diplomatik, Kryekonsull i Përgjithshëm në Milano deri më 2009 dhe më pas, deri më 2014, ambasador në Kajro – Egjipt. Të shumtë janë emigrantët shqiptarë, sidomos në Itali, të cilët flasin me simpatinë më të madhe për këtë diplomat të shkëlqyer, që aq shumë bëri për ta gjatë qëndrimit të tij në atë vend mik.

Z. Spartak është zotëruar i pesë gjuhëve të huaja. Edhe pas djales në pension ai ka vazhduar veprimtarinë si analist i politikës së jashtme të vendit dhe të asaj ndërkombëtare me botimet e shumta në organet qëndrore të shtypit. Madje mund të thuhet se sot është njëri nga analistët më të mirë dhe më objektivë në këtë drejtim. Në përvojën time të gjatë nuk kam ndeshur një analist të tillë me një bagazh të jashtëzakonshëm historik, me një kujtesë brilante dh mbi të gjitha, me një aftësi të rrallë të vlerësimit të ngjarjeve e të figurave të shquara si brenda edhe jasht vendit, që kanë bërë epokë. Në një takim të organizuar nga shtëpia botuese “Fan Noli”, kushtuar veprës madhore të Presidentit kinez Ji XhImping, në fjalën e tij, z. Spartak mahniti (e them pa superlativa) të gjithë auditorin për informacionin e gjithanshëm që dha, jo vetëm për Kinën, por sidomos për të gjithë ish drejtuesit e saj, saqë befasoi në kulm drejtuesit e Ambasadës Kineze në Tiranë.

Ne, miqtë e tij, prej kohësh kemi insistuar që informacionin e jashtëzakonshëm në plan kombëtar dhe ndërkombëtar ta përmbledhë në një vëllim të veçantë, që që po përpiqet të na e plotësojë këtë dëshirë të madhe.

Sikur të jetonin prindërit e këtyre intelektualëve fisnikë, sidomos babai, atdhetari i orëve të para, partizani i Gramozit, Hulësiu, që padrejtësisht u ndëshkua nga dktarura më e egër në Europë, do të krenoheshin me të vërtetë për të dy këta bij të vërtetë të familjes Topollaj, që vazhdojnë të nderojnë veten, atdheun dhe miqtë e tyre, që i mbajnë si model të jetës së sotme shoqërore.

Është fat i madh, që në këtë kohë krize të gjithanshme, të kesh miq të tillë dinjitozë si vëllezërit Shpendi e Spartak Topollaj.

* *Historian dhe përkthyes & “Mjeshtër i Madh”*

MEMORIAL PËR DËSHMORËT NË PORTËN E PARË TË LABËRISË

(Vijon nga faqja 12)

Dëshmorëve janë të shumta: Në Skërficë që u ndez flakë, / Luftë ditë e luftë natë, / Lufton Halili (Sullo) me Dalipnë (Kondin), / U gjakosnë për të mbrojtur Shqipërinë, / Seç nderojnë historinë, / Me gjak e shtuan lavdinë...”, si dhe “Lufta seç u ndez në qafë, / Të parët vanë djemtë tanë, Halili me Cenko djalnë, Rizali me Surjanë, Halili me Dalip asganë, Metja me Sejdinë, ç’e nderuan Shqipërinë...”, “... Fushëbardha maja e qafa mali, / S’të përkuli dot junani, / Se kishite zotë vatani, / U ngulët te insikami, / Nga Luvadhi në Skërficë, / Edhe nata bëhej ditë, / Dyqind burra të stërralltë, / Luftarakë djemtë tanë, / Për lirinë dhe për vatanë...”. Kohët

kanë ndryshuar, por historia ngelet dhe kur jemi të ulur në tavolinat e sigurisë botërore edhe në strukturat ekonomike europiane, sikurse ngelet ngatërrestar i ashtëquajtur “ligj lufte”. Me fqinjët tanë jemi në NATO, organizmin me të madh dhe më të sigurt të sigurisë Botërore. Me fqinjët do të jemi edhe në bashkimin europian, por identitetit kombëtar do të ngeket i pandryshuar dhe larg nacionalizmave.

Paqja dhe vetëm paqja dhe vëllazëria e Popujve dhe kombeve do të çojë njerëzimin përpara në prosperitet ekonomik dhe siguri kolektive. Nderimi dhe respekti dëshmorët që ngelen në lapidar është nderim për veprën heroike të luftëtarëve të Skërficës, është nderim për gjakun e derdhur të dëshmorëve për Shqipërinë tonë të dashur. -&-

SUPLEMENTI LETRAT

Fitues i çmimit të Ekselences në Letërsi



POEZI NGA POETI

MUHARREMKAMANI-PËRMET

Poeti Muharem Kamani konkuroi në Festivalin e Shoqatës Botërore të Akademisë së Poezisë që u zhvillua në qytetin e Selanikut me 03 Tetor 2024. Midis konkurentëve dhe çmimeve të tjera që u dhanë ai fitoi çmimin e Ekselences në Letërsi

Si dëshmorët gjakun derdhën
Dhe lirinë ne ta rritim.

Ja ku janë fare pranë
Në kodrat e historisë
Prehen trimat radhë-radhë
Ne ushtarë të lirisë

Në beteja dhe fitore
Ne u mbajmë prapë në ballë
Lapidarë e përmendore
Brez pas brezi veç të gjallë.

3. HIMN LIRISË

Si na ka ndjekur kjo fjalë
Mbjellë qysh në lashtësi
Që nga Arbrit dhe Dardanët
S'ka ndryshuar dhe tani.

Kemi ardhur nga Ilirët
Dhe ky emër ka kuptim
Ka kuptimin e shqiponjës
Ngritur lart në fluturim.

Ka kuptimin e folesë
Madhështore tek një shkëmb
Që s'pranon asnjë krijesë
Brenda saj të bëjë vend.

Do të na ndjekë kjo fjalë
Larg e në përjetësi
Në shekuj me gjak e larë
E shtrenjta jonë Liri.

4. BURIMI I NAIMIT

Ngrihet madhështor
Guri shekullor
Guri i Naimit
Pranë rridhte burimi
Ku vinte buzët bilbili.

Te burimi i Naimit
Vuri gjunjët Dritëroi
Piu ujë të lajthinjtë
Prapë burimi gurgulloi.

5. NË BUZË MBAJ NJË LULE

Oh, bija ime, të lutem
Mos e mbaj lapsin në gojë
Maja e tij është e mprehtë
E helmët si shigjetë e indianëve
Ka diçka prej hekuri të nxehtë
Nga putra e maces mbi koren e plagëve.

Jo lapsin në gojë, bija ime
Një lule do të jetë më mirë
Nuk je taksidare për tatime
Nuk je një burokratë e ngrirë.

Të ngrirëve u mungon dhe koka
Ata veç hijen mbajnë në zyrë
Madje u mungon qielli dhe toka
Të kafshojnë lapsin kanë detyrë.

Ka dhe gjykatës të mjerë
Që krekosen me lapsin në gojë
E njomin lapsin me vrer
Vaj me det mbi kë do të qëllojë.

Mos e mbaj lapsin ashtu, bija ime
Në zemër si ushtë ngule
Pastaj zër e mbaj shënime
Dhe midis buzëve mbaj një lule.

6. ATJE KU PREHET NËNA

Tek bregu, atje lart te burimi
Dashuria jote më solli, nënë
Aty ku vesa mbulon blerimin
Aty ku eshtrat e tua kanë rënë.

Shpirti dhe zemra më pikon
Vajton si mbi lule vesa e lehtë
Kujtimi m'i sjell lotët përgjithmonë
T'i derdh mbi varrin tënd të thjeshtë.

Lulet për ty, thesar i çmuar
Vijnë të të puthin ëmbël
Tek fle aty e qetë dhe menduar
Poshtë pllakave të gurta si engjëll.

Pranë dëllinjës roje përmbi varr
Qiririn e ndeza si pishtar
Pashë djalin që lule vendosi aty
Dhe ai kishte një lot në sy.

7. TROKITJET E TUA

Të ndiej si troket tek unë
Me shpërthime ndjenjash dashuri
Veç trokitja jote dashka shumë
Ëndërron të gjithë gjumin tim.

Veten e ndiej pendë të lehtë
Dhe lodhje nuk kam në punë
Vjen çapi yt aq i shtrenjtë
E zgjon një pranverë tek unë.

Trokitjet e tua më parë s'i njihja
Tani i përkthej në çdo gjuhë
Një det me dallgë të bën dashuria
Pranverë që vjeshtë s'ka kurrë.

8. KURORË E BUKUR KURORË

Kurorë e bukur, kurorë
Më je si një vetull vajze
Trëndelinë e luleborë

Retë si një fustan dasme.

Ujë i akullt i burimit
Humbet sa të thuash një fjalë
E pinë rojet e kufirit
Poshtë në vjosë do të dalë.

Ja, aty në ato male
Vigjëlojnë djemtë pa gjumë
Dhe bariu lart në stane
Është një kufitar më shumë.

9 QESHU, MBURRU, GJIROKASTËR

Gjirokastër ç'të qesh nuri
Për ty shkruaj me dashuri
O qytet i lashtë prej guri
E kalldrëmtë në histori.

Si Ajzberg i rënë nga mali
Kështjella ngrihet mbi re
Poshtë harqeve të gurtë
Kokulur rrinë armët trofe.

Qeshu, mburru, Gjirokastër
Për bijtë me mendje deti
Sa herë ngjit kalldrëmin lart
Të sjell diçka nga Përmeti.

Të sjell flade nga Naimi
Argjiro ngritur mbi shkëmb
Shekujt marrin fluturimin
Ti blerim të gurtë gdhënd.

10 DIKUR SI LULE E BRISHTË!

Dikur ish' si lule e brishtë
Vesë e diellit e spërkaste
Lahej e tëra në dritë
Syri i keq dot s'e kapte.
S'kuptonte pse buzëqeshte
Çdo djali me lakmi
T'i puthte pak syçkat deshte
Të binte në dashuri.
Ishte e urtë porsi një shqerë
Me zemër besoi një djalë
Larg atdheut kokëprerë
E la zogëzën duke qarë.
Pastaj i solli të tjerë
Në kurth krokodili
Vuante, vuante vajzë e mjerë
Tretej, tretej, si qiriri.
U vyshk siç vyshket një lule
Trupin sot e shet për bukë
Ajo malin mban mbi supe
Kur i thonë: prostitutë.

Muharem Kamani është një nga anëtarët më të vjetër të Klubit të Shkrimtarëve dhe

Artistëve "Naim Frashëri" Përmet. U lind më 3.02.1954, në fshatin Shelq të Përmetit, aktualisht banues në Përmet. Krijimtarinë e tij e ka filluar herët, qysh në bangot e shkollës ushtarake, ku vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij ka zënë publicistika dhe ngjarjet e kronikës. Si krijues në poezi ka filluar herët, por libri i tij i parë me lirika doli në dritë në vitin 2002 dhe vazhdon të shkruajë edhe sot. Është një nga poetët më aktivë të Klubit të shkrimtarëve dhe kryen me devotshmëri detyrat në fushën e artit dhe letërsisë. Ka marrë pjesë në disa shkrime në gazetatat e ndryshme letrare, si dhe në disa antologji të letërsisë shqipe të viteve të fundit. Aktualisht punon, krijon dhe banon në qytetin e Përmetit.

Për këtë nr. redaksia e gazetës "Veterani" boton disa nga poezitë e tij, përzgjedhur nga botim Kryetari i Klubit të Shkrimtarëve dhe Artistëve "Naim Frashëri" Përmet, Ligor Shyti.

1. MË SHFAQEJ NAIMI

Në Frashërin e largët
Mendja më shkon shpesh
Në pyjet me borë
Atje kam një jetë.

Në orët e natës
Lindte frymëzimi
Sa hapja kanatet
Më shfaqej Naimi,

2. AMANETI I TË RËNËVE

Një grusht Dhe nga toka mëmë
Pikon gjaku i shqiptarit
Amaneti nga të rënë
Më i rëndë se vetë mali.

Si rrëke na derdhen djersët
Truallin tonë të vaditim

SUPLEMENTI LETRAT

Në librin e 27-të të autorit, analiza të 40 veprave të 40 autorëve të njohur kombëtarë dhe dibranë
ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS



Prof. dr. Eshref Ymeri

• Në analizat e H.Ramës bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësnymin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike



“Kritika kërkon shumë më tepër formim kulturor, sesa krijimtaria”

Mjeshtri i penës, Halil Rama, njihet si një analist veprash të gjinive të ndryshme. Libri i tij i 27-të, i sapobotuar, “40 vepra letrare të 40 autorëve në ‘skaner’”, është një kaleidoskop idesh, përsiatjesh, faktesh. Janë 40 vepra të gjinive të ndryshme, të 40 autorëve, duke filluar nga vepra biografike e një autoreje amerikane, kushtuar jetës politike dhe artistike të ish-presidentit amerikan Ronald Reagan (Ronald Reagan -1911-2004), dhe duke vazhduar me krijimtarinë e autorëve tanë, të pasqyruar në prozë artistike, në poezi, në letërsi dokumentare, në diplomaci dhe në monografi.

Duke pasur parasysh këndvështrimet mjeshtërore të Halil Ramës, i cili ka një përvojë mjaft të pasur në fushën e kritikës letrare, lexuesi vëren se aparati i artit të këtij kritiku të talentuar shoqërohet nga tri të dhëna për autorët e veprave që ai analizon:

Së pari, autorët përthithin përshtypjet që kanë nga mjediset që i rrethojnë. Ato përshtypje, si në një fokus, grumbullohen në vetëdijen e tyre. Nga mijëra copëza vëzhgimesh, të shpërndara në hapësirat jetësore, vjen e krijohet diçka e tërësishme. Nga mijëra tiparesh të veçanta, të zbuluara në figurën e njerëzve që hasin në përditshmërinë e tyre dhe që ata i regjistrojnë në kujtesën e vet, vjen e krijohet një tip-pesonazh me vlera përgjithësuere. Nga mijëra pikësnyimesh që ata perceptojnë gjatë endjes së tyre në vorbullat e kohës, vjen e lind një pikësnyim tipik.

Së dyti, emocionet, faktet dhe mendimet e perceptuara, autorët i shndërrojnë në materie të artit.

Së treti, produkti i krijimtarisë së autorëve kthehet mbrapsht po në atë mjedis, prej nga qe vjelë, domethënë të lexuesi.

Ta perceptosh artin e kritikës, është po aq e vështirë, sa edhe ta krijosh atë. Çfarë bën kritika e Mjeshtrit të Madh Halil Rama dhe çfarë duhet të vazhdojë të bëjë ajo në këtë proces?

Me këtë pyetje, lexuesi i kësaj vepre zberthen detyrën e rëndësishme dhe të domosdoshme që ai i ka shtruar vetes: Kritika e tij shërben si shkollë për lexuesit dhe për autorët, ajo shërben si një universitet, si një enciklopedi, me pikësnyimin që ta ngrejë nivelin kulturor të të dyja palëve.

Qëllimi kryesor i analizave të Halil Ramës është vlerësimi i argumentuar i veprave letrare dhe përqendrimi i vëmendjes së lexuesit në kuptimin dhe

vlerën e tyre. Analiza e strukturës dhe e përmbajtjes së veprave është njëri nga parimet themelore të punës së tij hulumtuese, të konkretizuar në trajtimin e hollësishëm të përmbajtjes dhe të ideve të tyre. Ai e përqendron vëmendjen te elementet e kompozicionit, te zhvillimi i subjektivit, te karakteri i heronjve, te stili i rrëfimitarisë dhe te aspekte të tjera, të cilat ushtrojnë ndikim mbi mbresat e përgjithshme të veprave. Duke u ndalur në tiparet artistike të veprave, autori i ka shtruar vetes detyrën për të nxjerrë në pah dhe për të vlerësuar rolin e tyre edukativ në masën e lexuesve. Ai analizon gjuhën dhe stilin e veprave, aftësinë e autorëve të tyre për të krijuar figura të goditura artistike dhe për të shprehur mendime tejet të qëlluara.

Në këtë punim me vlera enciklopedike, autori Halil Rama u tërheq vëmendjen lexuesve te analiza kontekstuale. Gjatë vlerësimit të veprave të autorëve të ndryshëm, ai ka parasysh kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve. Ai studion rrethanat, në të cilat veprat qenë krijuar, veprat e mëparshme të disa prej autorëve, rëndësinë e tyre historike dhe sociale për vlerësimin sidomos të periudhës së diktaturës komuniste dhe të ca dukurive të rënda të periudhës neokomuniste, që pati nisur me vendosjen e demoshëmtisë dhjetoriste. Me analizat kontekstuale, Halil Rama i ndihmon lexuesit të kuptojnë edhe më mirë se çfarë roli luajnë veprat artistike në letërsi dhe në shoqëri.

Diçka tjetër që bie në sy në penën e Halil Ramës, është objektiviteti, një parim ky shumë i rëndësishëm në punën e kritikut letrar. Këtu ai ka parasysh një orientim të përgjithshëm: kritiku duhet ta vlerësojë një vepër artistike, pavarësisht nga parapëlqimet e veta subjektive dhe duhet të marrë parasysh këndvështrimin e lexuesve të ndryshëm; me këtë rast, ai ka të drejtë të shprehë

këndvështrimin e vet subjektiv, por ai duhet ta argumentojë bindshëm pozicionin e vet, duke marrë parasysh edhe normat shoqërore dhe kulturore. Pra, në këtë libër, puna e kritikut Halil Rama, mbështetet në analizën, vlerësimin dhe interpretimin e veprave të 40 autorëve, me qëllim që t’u vijë në ndihmë lexuesve të zberthejnë thelbin e përmbajtjes së tyre.

Në analizat e autorit bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësnyimin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike. Gjatë analizave, ai u është përmbajtur disa metodave të ndryshme origjinale, të cilat po i rendisim në vijim:

Së pari, metoda historike. Me këtë metodë nënkuptohet studimi i veprave në kontekstin e kohës dhe të rrethanave kur janë krijuar. Aty analizohen faktorë historikë dhe kulturorë, të cilët kanë ndikuar mbi autorët në krijimin e veprave në fjalë.

Së dyti, metoda strukturore. Analiza strukturore bazohet në studimin e organizimit dhe të kompozimit të veprave, analizohen elementet strukturore, të tilla, si subjekt, personazhet, gjuha dhe stili, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si bashkëveprojnë dhe formojnë një të tërë.

Së treti, metoda tematike. Gjatë përdorimit të metodës tematike, autori këtu analizon temat dhe idetë themelore të krejt korpusit të veprave të 40 krijuesve. Përmes kësaj metode, ai ka hulumtuar se si krijuesit në fjalë i kanë trajtuar probleme, çështje dhe koncepte të caktuara dhe se si i kanë lidhur me idenë e përgjithshme të secilës vepër.

Së katërti, metoda psikologjike. Me analizën psikologjike të veprave në fjalë, Halil Rama hedh dritë mbi botën e brendshme të personazheve dhe ecurinë e zhvillimit të tyre psikologjik. Ai ka analizuar motivet dhe komponentët

emocionalë të veprave, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si krijuesit i kanë përcjellë ato përmes personazheve të tyre.

Së pesti, metoda sociologjike. Me këtë metodë nënkuptohet përfshirja e aspekteve sociale, ekonomike dhe politike, të cilat janë pasqyruar në veprat e të gjithë krijuesve. Autori e ka vënë theksin te pasqyrimi nga ana e tyre i problemeve, normave dhe vlerave shoqërore.

Së gjashti, metoda krahasuese. Me analizat krahasuese në penën e Halil Ramës nënkuptohet ballafaqimi i veprës së një autori me veprat e tjera ose krahasimi i aspekteve të ndryshme të së njëjtës vepër. Kjo e ndihmon atë të hulumtojë edhe më thellë karakteristikat e veprave të analizuar dhe të zbulojë ngjashmëritë dhe dallimet me tyre.

Së shtati, metoda filozofike. Analizën filozofike autori e orienton drejt studimit të ideve filozofike që janë të pranishme në veprat e hulumtuara. Në analizat e tij ai ndalet në çështje fundamentale të të kuptuarit e jetës, të moralit dhe të aspekteve të tjera me rëndësi parësore.

Kjo vepër studimore në fushën e kritikës së veprave në disa gjini letrare, mund të vlerësohet pa asnjë mëdyshje si një dialog mes autorëve dhe lexuesve, ku kritiku Halil Rama shfaqet në rolin e ndërmjetësit që jep një ndihmë tejet të çmuar për të kuptuar dhe interpretuar veprat e kaq shumë autorëve.

Në këtë vepër përvojohet si ide kryesore tema “shkrimtari-kritikulexuesi”, ku detyra e kritikut është sa e mprehtë, aq edhe e rëndësishme. Kjo detyrë ka vetëm një zgjidhje: kritiku e ngre lart edhe kulturën e shkrimtarit, edhe kulturën e lexuesit.

Kur e mbaron së lexuari këtë vepër voluminoze, lexuesit i lind një pyetje e vetvetishme:

Si ka qenë e mundur që autori ka përballuar një punë kaq të madhe për përgatitjen e kësaj vepre të vëllimshme? Çfarë e ka ndihmuar? Shkalla e lartë e arsimimit, horizonti i gjerë kulturor, dëshira, fisnikëria e shpirtit, dashamirësia ndaj krijuesve të talentuar? Sigurisht që këto të gjitha kanë luajtur rolin e tyre të pazëvendësueshëm. Por ka edhe diçka tjetër, shumë të rëndësishme, që zbulohet në përgjigjen e pyetjes së mësipërme. Përgjigjen e ka pasë dhënë Presidenti i 30 (1923-1929) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Xhon Kalvin Kulixh (John Calvin Coolidge Jr.-1872-1933), i cili ka thënë:

“Në këtë botë, asgjë nuk mund ta zëvendësojë vullnetin e fortë, këmbënguljen. As gjeniu, gjeniu pa famë dhe i pashpërblyer s’është asgjë. As talenti, asgjë nuk haset më shpesh sesa talenti i dështuar. As arsimimi, bota është plotë me njerëz të arsimuar që janë të braktisur. Vullneti i fortë në arritjen e qëllimit-ja kjo është mrekullia vetë”.

FOTOREPORTAZH

Dr.Hasan Domi, dy gëzime në një ditë


Pas Tiranës, vepra enciklopedike “Bimët mjekësore të Korabit” promovohet edhe në Peshkopë, ku nga FPU dr.Hasan Domit iu dha titulli “Ambasador për paqe”



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Nga e shtuna e 26 tetorit 2024, studjuesit dhe pothuajse çdo familje dibrane do të kenë në bibliotekën e tyre veprën shumëdimensionale “Bimët mjekësore të Korabit” të dr. Hasan Domit - bashkëpunëtor i gazetës “VETERANI”. Do të më mjaftonte një studim i hollësishëm i saj, që si në promovimin të dielën e 20 tetorit 2024 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave në Tiranë dhe në prezantimin e saj të shtunën më 26 tetor në bibliotekën e Peshkopisë, të vlerësoja se “me këtë veprë enciklopedike, dr. Hasan Domi renditet me elitën shkencore të vendit”. Dhe nuk u zhgënjëva në këtë konstatim, pasi përfaqësues të elitës dibrane e vlerësuan pothuajse të tillë këtë veprë, si një libër të veçantë me karakteristikat shkencore dhe vlerat e pallogartishme kurative të 200 bimëve mjekësore të Korabit. Në promovimin që ju bë në Peshkopë, Prof. dr. Luigj Turmalaj, bashkëredaktor, njëherësh bashkënxënës në shkollën e mesme veterinarë Shkodër dhe bashkëstudent me studentin e shkëlqyer Hasan Domi në Institutin e Lartë Bujqësore, ndërsa vlerësoi profilin e lartë njerëzor dhe intelektual të këtij shkencëtari të vërtetë, tha se se libri “Bimët mjekësore të Korabit” është një kontribut i pazëvendësueshëm i Dr.Hasanit, nëpërmjet të cilit përshkruan me detaje pasuritë e jashtëzakonshme që Zoti na ka dhuruar. Ai e vlerësoi si të veçantë në llojin e vet këtë libër, pasi përshkruan jo vetëm bimët mjekësore të Korabit nominalisht, por sepse sjell informacion të trajtuar në mënyrë tradicionale dhe shkencore për efektet e dobishme kurative dhe nënyrën e përdorimit të secilës nga 200 bimët e studjuara prej autorit. Një veçanti tjetër sipas prof. Turmalaj konsiston në faktin se autori, falë përvojës profesionale shumëvjeçare ka përshkruar edhe disa bimë helmuese si dhe efektet e dëmshme në njerëz dhe kafshë, klinikën e tyre dhe kujdesin për të shmangur efektet e padëshiruara. Në një mendje me Prof. Turmalaj, ishin edhe sipërmarrësi i suksesshëm Veli Rrapi si dhe bashkëkohësit e autorit, studjuesit e mirëfilltë dibranë: publicisti i mirënjohur Osman Xhili - kryetar i LID për Maqellarën, Denisa Basha - drejtore

Mjeshtri i Madh: LEONARD TASE: “Dibra, mirpritjen e ka në ADN-në e saj”



e Trashëgimisë kulturore në Bashkinë e Dibrës, ish kryetarja e Këshillit të Qarkut Dibër Valentina Hali-ti Doda - drejtore e shkollës “Demir Gashi” Peshkopi, kuadrot e devotshëm dibranë Fadil Begu, Ing. Bekim Qosja, Petrit Rama, Fariz Cibaku, Rushit Ferati e Fatmir Zhuzhi. E përbashkëta në fjalët e tyre përshëndetëse në promovimin në Peshkopë, ishte puna voluminoze disavjeçare e dr. Hasanit për evidentimin e pasurisë së pallogaristhme që bart rrafshnalta e Korabit, si dhe domosdoshmëria e studimit dhe vendi i veçantë që zë kjo veprë në mjekësinë alternative. Kjo edhe për faktin se siç vlerëson recenzenti i veprës, prof. dr. Nefail Biba: “Punimi/libri sjell në vëmendje të lexuesit një numër të konsiderueshëm bimësh mjekësore të krahinës si: boronica, salepi, kamomila, hithra, sherbela, çanta e bariut, çikorja, rigoni, çaji i malit, bari i qenit, haraqina, shafrani i Korabit, laboti, zambaku i Korabit, helmari-

na, lulekuqia, petriku (fik ujku), lotzoja, shpendra, hisopi mjekësor, etj, mjaft prej të cilave shoqërohen me një informacion të ri, do të thosha, si: emërtimi sipas zonës, përdorimi për qëllime mjekësore sipas traditës së zonës, spjegimi i etimologjisë së emërtimit popullor apo dhe latin, historia e përdorimit mjekësor që nga lashtësia, etj. Po kështu historitë e ardhjes në Ballkan të disa bimëve frutore si: arra, pjeshka, kajsia, apo patatja, bamja, argjinarja, çaji, duhani, etj”.

Vlerësime maksimale për këtë veprë shumëdimensionale prej 705 faqesh, me vlera të rralla studimore, ku ka konsultuar literaturë nga qindra autorë vendas e të huaj dhe me rend alfabetik mjaftë të pasur, autori Domi mori dhe nga kryetari i Bashkisë Dibër Rahim Spahiu si dhe nga kryetarja e Këshillit të Qarkut Dibër Alma Selami.

Kryebashkiaku Spahiu, ndërsa e uroi autorin në emër të gjithë dibranëve për veprën e tij me vlera të rralla shkencore e studimore, evidenetoit kontributin e tij si mbështetje reale për industrinë e bimëve medicinale,

Ndërsa Leonard Tase, emblemë e volejbollit modern që solli risi në fushën e volejbollit në Shqipëri dhe që njihet jo vetëm për kontributet e tij në sportin e volejbollit si lojtar apo organizator dhe më pas si trajner, por edhe për mbështetjen që gëzon në Evropë dhe me gjerë nga BVA - CEV - FIVB dhe krerët më të lartë të

volejbollit në botë (si Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Volejbollit FSHV për afro dy dekada), i impresionuar nga vlerësimi që iu bë veprës së dr. Domit në sallën e bibliotekës Peshkopi, ndër të tjera tha se Dibra, mikpritjen e ka në ADN-në e saj.

Çast emocionant, për studjuesit dibranë që finalizimi i këtij eventi me dhënien e titullit “Ambasador për paqe”, dr. Hasan Domit nga Federata e Paqes Universale Shqipëri. Nën kryetari i kësaj Federate, Abdulla Domi, ndër të tjera tha se ky titull jepet në vlerësim të veprës së dr. Hasanit pasi “Ky botim i shkruar me kompetencë e profesionalizëm, pas një pune të gjatë studimore prej tij, sjell një copëz me vlerë të pasurisë sonë kombëtare, si ekosistemi i Korabit me bimë mjekësore shumë cilësore. Me këtë veprë ai dëshmon lidhjen shpirtërore me bimët e Korabit, me aromën e tyre. Ndaj dhe i është kushtuar për një kohë të gjatë shkrimit dhe botimit të librit ‘Bimët Mjekësore të Korabit’, me passion për t’u admiruar”.

Kjo veprë (që tashmë gjendet edhe në bibliotekën e Peshkopisë, e dhuruar nga autori) më përpara ka marrë ekspertizën dhe është vlerësuar nga autoritete shkencore në rand vendi, si nga prof. dr. Ethem Ruka, rektor i Universitetit “Luarasi” dhe prof. dr. Petrit Bara, zv/rektor i këtij universiteti, njëherësh redaktor i saj. Ndërkohë, për domosdoshmërinë e studimit të hollësishëm të kësaj veprë enciklopedike, në këto veprimtari promovuese të moderuar me mjeshtri të rrallë artistike nga Mjeshtri i Madh Defrim Methasani (si edhe në hyrje të librit), janë shprehur edhe Prof. dr. Jordan Daci (një nga juristët më të mirë në rang kombëtar), Prof. dr. Skënder Durrësi, Dr. Dhimitër Brano e Prof. dr. Enver Roshi, pedagog në Universitetin e Mjekësisë.

Fotot nga FEHMI LLESHI

